


# LAJMETARI

## I BERATIT



Viti III, Nr. 48 (123) E përjavshme e pavarur E hënë, 16 janar 2006 Çmimi 20 lekë ( 1 Euro)  
Adresa: Lagjja "Dëshmorët e Kombit", pranë shtypshkronjës "Lirsan Ekspres". Tel: + 069 2247353 Adresa në internet: www.lajmetari.net e-mail: redaksia@lajmetari.net

**P O L I T I K Ë**  
*Abedin Kaja*

**Rama: "Është më e lehtë të marrësh një vizë Shengen se sa tesarën e PS-së"**

Faqe 2

**S T R E S**  
*Bujar Orizaj*

**Erion Braçja vazhdon fushatën elektorale në Berat**

Faqe 6

**D E B A T**  
*Stavër Bobo*

**Pasi realizoi qëllimet, Pal Shkarpa braktisi grupin e këngës qytetare**

Faqe 13

**O P I N I O N**  
*Alban Guri*

**ZILIA NJEREZORE, ARMIKU ME I MADH I QYTETERIMIT!**

Faqe 10


**E D I T O R I A L**

**Lagjja "30 - vjetori" kërkon të marrë frymë lirisht**

Berati nesër mund të jetë qytet i shenjuar si pjesë e trashgimisë kulturore botërore për ato vlera që ka. Për të arritur deri këtu kanë punuar breza të tërë të banorëve të tij. Por kur kalon përmes njërës nga lagjet e reja të këtij qyteti ndihesh ligisht. Jo më shumë se 300 metra nga qendra e qytetit gjendet lagjja "30 Vjetori". Edhe këtë vit ajo lagje është pushtuar nga tregu i tezgave, ku janë ngritur shitore të rrethuara me plastmas dhe lloj-lloj leckash e batanijesh të vjetra. Ky treg ka të punësuar mjaft njerëz që kundrejt një pagese ditore prej 30 lekësh tregtojnë gjithfarë mallrash me cmime të lira, por me një cilësi të ulët. Qytetarët e varfër të Beratit, ku papunësia është ulur këmbëkryq, mashtrohen nga cmimet e ulta dhe blejnë mallra pa vlerë. Nga ky pazar jashtë cdo kontrolli po shkatërrohet cdo ditë biznesi i rregullt i tregtoresh të paisura me licencë, biznesi që paguan të gjitha taksat dhe tregton mallra pak a shumë cilësorë. Por edhe më shqetësues bëhet ky lloj pazari për lagjen "30 Vjetori" dhe gjithë qytetin e Beratit në këndvështrimin mjedisor. Lagjja nuk merr frymë nga mbetjet e pazarit, nga ndotja akustike, nga rrethimi i rrugës dhe rrugicave, nga pushtimi i shesheve e mjediseve para pallateve.

Ndonëse ky problem është ngritur në media, bashkia e Beratit ende nuk ka gjetur një rrugëzgjdhje. Këshilli i bashkisë duhej ta kishte marrë në shqyrtim dhe duhej ta kishte zgjidhur me kohë këtë problem. Sidoqoftë qytetarët e lagjes "30 Vjetori", biznesmenët e Beratit ende shpresojnë se këshilli i bashkisë do ta zgjidhë më në fund këtë çështje dhe do t'i kthejë frymëmarrjen kësaj lagjeje dhe gjithë qytetit. Berati, një qytet me fytyrë në Shqipëri, kurrsesi nuk mund të lihet në këtë gjendje, qoftë edhe në një pjesë të tij. Dikush mund të thotë se me punën e atyre tezgave ushqehen disa familje. Por tregtarët e dyqaneve në Berat mendojnë ndryshe. Ata thonë se nga shkatërrimi i bizneseve të rregullta në Berat, për shkak të këtij pazari kanë humbur e humbasin përditë vendet e punës dhjetra e dhjetra vetë.

Y. Hima



Kryetari i PS-së Edi Rama në Berat

**URA E GORICËS JEP SINJALIN "SOS"**

Faqe 2

**Zoti kryetar i bashkisë, a e dini se për çfarë ka nevojë sporti?**

Faqe 7

*Elham Pasha*

**Katmanduja e trakteve**

Faqe 7

**Pegas 2005-2006**

**Ese nga Erinda Gjata**

Faqe 8-9

**Rrëfenja**

nga Agim Mehqemeja, Namik Selmani.

Faqe 14

**Faqja sportive**

nga Vlash Pambuku

Faqe 15-16

**Shtëpia e Bojërave**

— —

B... , plastiko, hidro... pigmente etj...

Tel: 3... micro.it.

... në post...

**Si mund të mbroni automjetet tuaja?**

**TEXACO**

Përdorni vajra të cilësisë së lartë

**KËTU DO TË GJENI** me shumicë dhe pakicë:

Shell FILTRA

... ndryshme ... të cilësisë së lartë ... (eskavator, fadrom, ... kamion, etj)

... bimi me porosi për auto... rënda (eskavator, fadrom, ... kamion, etj)

a: ... arku i Urës Vajgu ... allë Western Unio

nistrator: Edison ... beshi


l: 0682235888; 0 ... 22

## Rama: "Është më e lehtë të marrësh një vizë Shengen se sa tesorën e PS-së"

**Diskutohet xhela e flokëve të Kojës dhe Braçes  
Rama thotë se Berishën do ta takoj vetëm në institucione  
PS-ja duhet të hapë portat për të rinjtë**

Është zhvilluar dje rreth orës 10:00 në ambientet e Pallatit të Kulturës "M.Tutulani" një takim me pjesëmarrjen e antarëve dhe simpatizantëve të PS të rrethit Berat. Në këtë takim, krahas përfaqësuesve vendorë, të PS merrete pjesë edhe kryetari i PS të Shqipërisë z.Edi Rama, i shoqëruar nga deputetët Erion Braçe, Arta Dade si dhe nga sekretari i burimeve njerëzore në PS z.Blendi Klosi. Qëllimi i këtij takimi, i cili filloi dhe hapjen e fushatës zgjedhore në PS, ishte aplikimi i mënyrës së re që do të zbatohet për ristrukturimin e PS nëpërmjet zgjedhjeve duke aplikuar parimin një antarë një votë. Takimin e hapu kryetari i PS të rrethit z.Bashkim Çela. Pasi foli për punën e deritanishme të strukturave të PS në Berat në drejtim të përgatitjes së procesit zgjedhor, fjalën ia dha z.Edi Rama. Kryetari PS të Shqipërisë Edi Rama u shpreh: "Ju falenderoj të gjithëve që në mëngjesin e kësaj dite pushimi i jeni kushtuar këtij aktiviteti që është një aktivitet i rëndësishëm për faktin se shënon fillimin zyrtar të procesit të zgjedhjeve në PS të Beratit qytet dhe të rrethit." Duke folur për reformën zgjedhore në PS midis të tjerash z.Rama u shpreh se PS kaloi pa shumë fjalë drejtpërdrejt në një reformë duke përqafuar parimin një antarë një votë dhe duke ftuar konkretisht sot këtu në Berat, Fier, Lushnje, Vlorë, Durrës dhe kështu me radhë në dhjetë qendrat urbane të Shqipërisë, të gjithë antarësinë të shprehet për votimin e kryetarit të partisë. Ky është një hap madhor jo vetëm për PS, por për të gjithë politikën shqiptare, ky është një hap që antarin e PS e vendos në qendër të vendimmarrjes së

partisë dhe ky është një fakt dhe mbi këtë fakt ne do të ngrejme një PS që do të jetë në gjendje ta harmonizojë traditën e vet më të mirë dhe ambicjen tonë të madhe për të ndërtuar një të ardhme ndryshe. Lidhur me qeverisjen e PS kur ajo të vijë në pushtet z.Rama, në vijim të fjalës së tij tha se ne nuk do të marrim disa të rinjë bukurshë dhe të buzëqeshur për t'i nxjerrë përpara kamerave si njerëz të ndryshimit, nuk do të ulim as disa ekspert sado të zotë të jenë në disa salla të mbyllura për të shkruajtur premtimet për popullin. Ne do të marrim drejtpërdrejt informacionin në të katër anët e Shqipërisë dhe do të dëgjojmë të gjithë ata që do të duan të na flasin për të shkruar programin tonë elektoral dhe transformimi ynë nuk do të jetë transformim kozmetik, por do të jetë transformim real. Po kështu, lidhur me përbërjen e forumeve të partisë dhe të zgjedhura në këto forume, z.Rama theksoi domosdoshmërinë e një pjesëmarrje më të lartë të grave dhe të rinjve në këto forume. "Detyrimisht, tha ai, në komitete e reja drejtuese që do të krijohen duhet të ketë 30% gra dhe 30% të rinj. Në këto forume duhet të harmonizohen të gjitha shtresat dhe moshat, të cilat do të jenë laboratorë të hapur të diskutimit të ideve." Midis nesh, vazhdoi më poshtë Rama, nuk ka asgjë për tu ndarë, përkundrazi ka vetëm një betejë të ashpër opozitare si detyrë për të mbrojtur të gjithë shqipëtarët dhe për të qenë të vëmendshëm ndaj çdo hapi që kjo qeveri po hedh në drejtim të ndryshëm me interesat e integritimit të BE, në drejtim të ndryshëm megjithë ato arritje që



u krahasuan me tetë vjet pasi u dëshëm të nisnim nga e para, sepse kryeministri i sotëm dhe ish-presidenti i djeshëm na e la Shqipërinë shkruar e hi. Dëshiroj të theksoj se në kampin opozitar ne jemi një parti e ngulur fort në principe të vullnetarizmit që bazohet në respektin për kundërshtarit si një vlerat e sistemit, por njëkohësisht në mungesën e vullnetit për të bërë kompromis me gjithçka që nuk përkon me interesat e vendit, me interesat e përbashkëta, me interesat e atyre që përfaqësojmë. Ne në fakt e kemi takuar shpesh Berishën, e kemi takuar në rrugët e bllokua, në gjykatën kushtetuese ku jemi drejtuar për të ankimuar për vendimet arbitrare në kundërshtim me Kushtetutën, e kemi takuar po ashtu në prokurori dhe do të vazhdojmë ta takojmë në të gjitha institucionet e vendit. Ne nuk vuajmë nga mungesa e takimeve, përkundrazi po e takojmë shumë, ashtu si kundër do ta takojmë kryeministrin e PD me të gjitha partitë e tjera në tryezën e reformës zgjedhore, por nuk kemi asnjë dëshirë dhe s'kemi asnjë minutë për të humbur për ta takuar jashtë këtyre institucioneve, sepse na vjen shumë zor". Kërkesës të njerit prej antarëve të PS në sallë për bashkëpunimin me LSI, pasi siç u shpreh ky antarë i PS, z.Meta ka kontribuar për Partinë Socialiste dhe se

votuesit e LSI janë miqtë dhe shokët tanë dhe se ne nuk mund të votojmë kundër njeri-tjetrit, z.Rama iu përgjigj se ne jemi të hapur për të bashkëpunuar me të gjitha partitë opozitare, por nuk pranojmë bashkëpunim me kusht.

Luli Bajrami, që sipas tij në këtë takim përfaqësonte socialistët çamë, i kërkoi z.Rama që të kërkojë të bëhet më shumë në drejtim të infrastrukturës së qytetit. Ai u shpreh se nuk është mirë që politikanë të rinj në moshë si Gjergji Koja apo Erion Braçe të paraqiten përpara publikut me kokën të lyer me xhel, pasi ky veprim nuk i përgjigjet realitetit shqipëtar. Në përgjigje të kësaj kërkese z.Rama tha me humor se këtu kemi ardhur për të diskutuar rreth reformës zgjedhore dhe jo për parukerinë. Agim Jace falënderoi median për pasqyrimin real që iu ka bërë zhvillimeve në PS. Ai u shpreh se reformimin e PS-së mund ta bëjnë vetëm të rinjtë në udhëheqje të saj. Nëse nuk ndodh kështu unë mendoj se zgjedhjet e ardhshme të pushtetit vendor i kemi të humbura.


Në përfundim sekretari i burimeve njerëzore në PS Blendi Klosi foli për reformën zgjedhore e u shpreh se kërkohet një pjesëmarrje më e madhe e grave dhe të rinjve në përbërje të antarësisë dhe të forumeve të PS, pasi konstatojmë me keqardhje se moshë mesatare e antarësisë së PS sot është 50 vjeç, ndaj ky realitet duhet të ndryshojë duke e shtuar antarësinë dhe të zgjedhurit në forumet e PS në masën 30% si për gratë ashtu edhe për të rinjtë.

Abedin Kaja

Ura e Goricës e kthyer nga urë druri në urë guri në shekullin e XVIII, është ndërtuar më 1780 nën kujdesin e Ahmet Kurt Pashës dhe e rindërtuar në vitin 1920-1930. Ajo ka mundur t'u rezistojë 225 viteve duke sfiduar kohë dhe periudha nga më të çuditshmet, por ajo nuk po u reziston dot ndryshimeve të pas viteve '90 të sistemit demokratik "alla shqiptar". Shfrytëzimi barbar dhe lënia në harresë e kësaj veprë të rrallë e shpallur monument kulture ka bërë që ajo sot të jetë futur drejt shkatërrimit të saj. Askush gjatë këtyre 15 vjetëve nuk është kujtuar për të ndermarë ndonjë investim në funksion të riparimit dhe mirembajtjes së saj. Kjo vepër e rrallë për nga ndërtimi arkitektonik që i bënë nder qytetit mes ansambilit të vlerave të papërsëritshme kulturore, arkitektonike dhe historike për shkak të lënies në harresë dhe shfrytëzimit barbar të saj, ka dhënë sinjalin "SOS". Ura është 129.3m e gjatë, 5.3m e gjerë dhe me një hapësirë mes harqeve nga 9-16.7m. Kjo urë ngrihet 10m mbi shtratin e lumit Osum dhe përbëhet nga 7 harqe. Sipas legjendës në këmbën e parë të saj në kohën e rindërtimit, ekzistonte një zgarë dhe një

## URA E GORICËS JEP SINJALIN "SOS"

kamare e madhe e mbyllur me hekura në të cilën do të ishte e mbyllur një vashë, e lënë të vdiste aty nga uria si fli për t'u bërë ballë shpritrave të këqinjë që nuk donin ndërtimin e urës. Në këtë zgarë gjatë restaurimit të saj u gjet një kokë femre e gdhendur në dru. Është një vepër e gjitha e ndërtuar me gurë të bardhë të skalitur dhe punuar hijshëm. Ura ngrihet mbi një bazament të fuqishëm dhe shtrihet në të dyja pjesët e lagjeve muzeale "Mangalem" dhe "Goricë". Përgjatë gjithë periudhës së ekzistencës së kësaj ure nuk është ndërtuar një tjetër e tillë në qytetin e Beratit edhe pse nevoja për ndërtimin e një ure tjetër ka qenë tepër e domosdoshme. Ura e Goricës që lidh dy lagjet muze -muze "Mangalem" dhe "Goricë", së bashku me këto lagje, përbëjnë tri nga mrekullitë me vlera të papërsëritshme me të cilat krenohet jo vetëm qyteti i Beratit, por edhe e gjithë Shqipëria. Vlerat e rralla muzeale, kulturore, historike dhe arkitektonike që mbartin këto lagje do ta bënin Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Evropës Terri



Dejvis të bënte këtë vlerësim krahasues për Beratin "Nëse Pjetri i madh i Ruisë e pa Evropën nga një dritare e Petërburgut, ju shqiptarët e shikoni nga njëmijë dritare të qytetit të Beratit".

E sollëm këtë panoramë të përgjithshme të të gjithë këtij ansambli për të treguar se është Ura e Goricës ajo që i lidh dhe i bën të komunikojnë njëra me tjetrën duke i kthyer në një të tërë këto lagje me vlera të rralla. Ura e Goricës për disa shekuj

ka shërbyer si nyje lidhëse e Shqipërisë së Mesme dhe asaj të Veriut me Jugun e Shqipërisë, Greqisë dhe gjithë Orientin. Është pikërisht kjo urë që ka pritur dhe përcjellë mijëra kalimtarë, të cilët i ka mbajtur mbi shpinën elegante të saj. Tashmë kjo urë është katandisur në një gjendje të tillë që tregon se ajo nuk ndodhet në kohë të reja dhe përdoret nga njerëzit e shekullit të ri, por përdoret nga barbarët që janë betuar ta shfarrosin atë nga faqja e

dheut. Është normale që ajo të dobësohet dhe të pësojë dëmtime, por është e pafalshme që të mos ndërhyet për ta riparuar atë, por të vazhdohet edhe më tej drejt shkatërrimit të saj duke mos e riparuar dhe marrë në mbrojtje. Vitet e fundit ajo ka pasur dëmtime të mëdha në të gjithë trupin e saj, janë çarë këmbët dhe harqet e saj si dhe ka dëmtime të pjesshme në të gjitha pjesët e murit. Kjo urë e ndërtuar para dy shekuj e gjysmë më parë nuk ishte

parashikuar që të mbante mbi shpinën e saj mjete të tonazhit të rëndë sikur të ishte një masë shkëmbore dhe jo vepër arti e llogaritur që në të të kalonin vetëm këmbësorë dhe mjete me kapacitet të vogël transporti. Ajo që është edhe më e patolerueshme është fakti se deri tani ajo vetëm është shfrytëzuar deri në atë pikë sa që tashmë ka ndezur dritën e kuqe të sinjalit "SOS". E vetmja masë që është marrë nga pushtetarët për ta mbrojtur këtë urë nga dëmtimet e mëtejshme është vendosja mbi shpinën e saj e disa blloqeve të rëndë betoni me qëlim ngushtimin e sipërfaqes së kalueshme mbi të, për të mos lejuar ndërrimin mbi këtë urë të mjeteve me tonazhe të rëndë. Ndërsa për ta riparuar atë dhe ndërtuar një urë tjetër as që mendohet, pasi, siç na thonë në bashkinë e qytetit, fondi prej 3 milionë lekë gjithsej i dhënë për këtë bashki për vitin 2006 është i pamjaftueshëm për ndërhyrje të tilla. A mos vallë ky problem lindi sot ndërkohë që miliona lekë investime janë harxhuar për rrugë që ende vazhdojnë të jenë të prishura dhe miliona të tjera për kanalizime, lulishte etj, që

## Çfarë fshihet pas këmbënguljes së Ben Blushit

Ben Blushi në emër të PS-së i ka vënë kusht PD-së se ata nuk do të pranojnë ndryshime në kodin zgjedhor, nëse nuk pranohet kërkesa e tyre për zgjedhjen e Presidentit me votim mbarëpopullor.

Në pamje të parë kjo kërkesë duket si normale. Zgjedhja e Presidentit me votim është një praktikë e njohur, por për republikat presidenciale, mesa është

deklaruar vite më parë, dhe jo për republikat parlamentare. Kështu që duhet ndryshuar Kushtetuta që të bëhet e zbatueshme kjo kërkesë.

Me të drejtë lind pyetja:

Çfarë fshihet pas kësaj këmbëngulje të socialistëve?

Mendoj se arsyeja e parë lidhet me rikthimin e Fatos Nanos në politikë dhe për kandidimin e tij për President.

Nëse ky dyshim nuk qendron, se nuk ka për ta pranuar Edi Rama këtë kandidaturë, meqë ai e ka bojkotuar atë në të gjitha drejtimit, të paktën do të justifikohen para opinionit të anëtarësisë së partisë që janë pro Nanos, atëherë lepurit fle gjetkë dhe duhet parë më vonë se ku fle ky lepur.

Siç shihet është po ajo praktikë që kjo parti ka ndjekur gjatë tetë viteve që

ka qenë në pushtet, gjithmonë duke nxjerrë ndonjë gjë të re, të pengojë kodin zgjedhor me një kërkesë që nuk mund të pranohet pa ndryshimin e Kushtetutës dhe jo vetëm për këtë kërkesë, por edhe për kërkesa të tjera që i ka kërkuar PD-ja dhe që nuk i ka pranuar PS-ja, me qëllim që fajin t'ia hedhë PD-së për shkelje të premtimeve të dhëna gjatë fushatës për një kod të ri që të sigurojë zgjedhje të ndershme.

Mos harroni se ishte po kjo parti që zbatoi Dushkun së pari në zgjedhje dhe që këmbënguli edhe për zgjedhjet e 3 korrikut që kodi zgjedhor të mos e ndryshonte këtë pikë. Edhe pse PD nguli këmbë me forcë që kjo praktikë të

ndryshonte, ajo nuk pranoi.

Edhe kur Sali Berisha deklaroi se Dushkun do t'i përgjigjej po me Dushkun, PS sërish nguli këmbë në të sajën. Dhe kur e pa se dështoi në zgjedhjet e fundit, e ngriti zërin përsëri tani për Megadushkun duke ia faturuar PD-së faturën e fajit të saj.

Kështu që s'ka dyshim se PS nëpërmjet Ben Blushit synon të arrijë ato qëllime që janë jo në dobi të zgjedhjeve, por në dobi të demaskimit të PD-së si pengesa e vetme për zgjedhjet e pritshme për pushtetin vendor dhe për zgjedhjen e Presidentin.

Ben Blushi

Agim Mehqemeja


## Pleqërinë nuk e do kush!

Në qoshe të rrugicës sonë është një dyqan i vogël ushqimor, ku për ditë me orë të tëra te dera e tij si një monument kulture, qëndron si statujë një i moshuar. I ka kaluar të tetëdhjetat, por fiziku tregon një trup të lidhur se

me abonentin që komunikonte në anën tjetër të telefonit.

Dukej që ishte një bisedë nga larg, por që u zbërthye lehtë me të mbyllur receptorin. Kunata në anën tjetër, emigrante përtej oqeanit, kërkonte

Sa pati të shoqen gjallë, ajo i shërbeu dhe e mbante hijshëm, me veshje e mbathje si pak moshatarë të tij. Me ndarjen e saj nga jeta, plaku mbeti fillikat dhe e ndjeu shumë mungesën e së shoqes. Të vetmin djalë që ka është i



në rini të vet ka jetuar mirë. Edhe nga veshja, të krijon përshtypjen e një njeriu të rregullt. Përherë i qetë në qetësinë e vet, i pastërt dhe i urtë si rrallëkush se me thënë të drejtën pleqtë janë ca zevzekë.

Edhe pse nuk e jep veten, shpesh e shoh të menduar, thellë me tërë qenien, të përhumbur e mendja, jo rrallë, më ka shkuar ta pyes, por prapë jam tërhequr për të mos e vënë në siklet.

Një copëz bisede telefonike shpërbëri fillin e enigmës që mbështillte misterin e jetës së plakut.

-Nëse e do babanë, po ta nis pako postale nga Rinasi, së bashku me paratë e shtëpive e kursimet që ka vënë mënjanë, -foli prerë

pjesën në të holla të shtëpisë së shitur. Me vdekjen e së shoqes, plaku mbeti si kërcu e s'kishte kush t'i shërbente, ndaj shiti shtëpinë e u mblodh pas vajzës së madhe në një qytet tjetër, jo larg vendbanimit të përhershëm. Të gjithë e miratuan veprimin. E priti edhe e bija më e vogël emigrante në shtetin fqinjë.

-Nëse ju duhet ndihmë ekonomike, më telefononi. Jam gati të kontribuoj që babait të mos i mungojë asgjë, - u përgjigjën njëzëri burrë e grua. Kjo ishte udhëzgjdhja më e drejtë në të mirë të të dy palëve, në pamundësi për ta tërhequr në dhe të huaj, ku edhe vetë i ati nuk desh t'u bëhej barrë.

ikur larg, shumë larg. As në vdekjen e s'ëmës nuk mori mundimin të vinte e t'i hidhte një dorë dhë. E sot, pa pikë turpi, burrë e grua, kanë sy e faqe e kërkojnë pjesën e shtëpisë së shitur. Gjithkush e ka një hall, po halli hallit nuk i ngjan.

Pa halle e telashe nuk ka familje, se jo gjithnjë jeta shkon si në vaj. Më tingëllojnë si këmbanë në vesh edhe pse kalojnë vite, fllaët "Mos të lëntë Zoti pa grua në pleqëri".

Këto porosi kapitale, janë të pranishme në shumë familje tonat, e mbeten temë bisedash e diskutimesh sociale për shumë kohë në mjedise familjare e publike, një shqetësim përherë i pranishëm, vështirë për t'u

### NJOFTIM PER VEND TE LIRE PUNE

Ne zbatim te Ligjit Nr.8549, date 11.11.1999. "Statusi i nepunesit civil", Drejtoria e Burimeve Njerezore ne Bashkine e Kuçoves, shpall konkurimin per nje vend te lire pune ne pozicionin:

#### Inxhinier ndertimi ne Drejtorine Ekonomike te Arsimit

Kandidatet duhet te plotesojne kerkesat e pergjithshme sipas nenit 12 te Ligjit 8549, date 11.11.1999, "Statusi i nepunesit Civil".

##### Kerkesat e vecanta per kandidatet jane :

1. Te kete mbaruar arsimin e larte ne nje nga deget e Fakultetit Ing. Ndertimi.
2. Te perdore lehtesisht programet baze te kompjuterit.
3. Te kete aftesi te mira menaxhuese dhe te punes ne grup. Paga eshte 17.578 leke shtese pozicioni + 9306 paga e grupit + 2% per çdo vit vjetërsi.

##### Dokumentat qe duhet te plotesojne kandidatet jane :

1. Kerkesen per aplikim
2. Curriculum vitae
3. Fotokopje e diplomes dhe listes se notave (e noterizuar).
4. Fotokopje e certifikatave te kualifikimit (e noterizuar).
5. Fotokopje e deshmise se kompjuterit (e noterizuar).
6. Vertetim i gjendjes gjyqesore
7. Fotokopje e librezes se punes ( n.q.se do te kete ).
8. Mosparaqitje e plote e dokumentave sjell skualifikim te kandidatit
9. Afati i dorezimit te dokumentave eshte deri ne daten 15.02.2006

Konkurimi eshte i hapur per nepunesit civile te se njetes klase nepermjet procedurave te levizjes paralele, si dhe per kandidatet administrates publike sipas procedurave te pranimit ne sherbime.

Pas verifikimit paraprak, ne daten 20.02.2006, ora 11.00 Bashkise Kuçove do te zhvillohet testimi me shkrim dhe me kandidatëve.

## Dy kremtime në një ditë

6 janari na hyri me dy kremtime: me Bekimin e Ujit, që e gjeti pasqyrimin e vet edhe në shtyp, dhe me koncertin e këngëtares së re të talentuar Olsa Spata që nuk arriti të pasqyrohej në shtyp, dhe që duhej ta kryenin këtë detyrë jo vetëm gazetarët, por, në veçanti, ata që e njohin muzikën dhe që e kanë për detyrë ta pasqyrojnë atë.

Unë e mora përsipër të shkruaj diçka për këtë koncert thjesht si dashamirë i këngës popullore dhe si një dëgjues i emocionuar nga zëri i Olsës.

Pas ceremonisë së hedhjes së kryqit në ujërat e Osumit, më tërhoqi vëmendjen afishja që na ftonte të ndiqnim koncertin recital të këngëtares së re dhe të talentuar Olsa Spata.

Pati shumë dashamirë të këngës që dëshironin ta ndiqnin këtë koncert të pritur prej tyre, aqsa organizatorët u detyruan t'i hapnin dyert e pallatit të kulturës "Margarita Tutulani".

Fillimi i koncertit u prit me duartrokite, kur në skenë doli Olsa e veshur me kostum popullor qytetar.

Koncerti, i përgatitur nga kompozitori Avram Buda, me regji të Ylli

Mestanit, u hap me këngën-himn "Mora përpjetë Kalanë".

Olsa këndoi shumë këngë të bukura. Atë e shoqëronin në kor të gjithë të pranishmit, duke ngjallur traditën e të kënduarit në bashkësi të këngës qytetare beratare. Dhe s'kishte më bukur! Beratare i rritur me këngë, i kërkon këto koncerte, në veçanti kur sheh këngëtarë të rinj që të ngjiten në skenë dhe të rriten para syve të tij.

Këngëtares Olsa Spata e përshëndeti një emigrant beratas që punon në Greqi si kantautor dhe që këndoi për të me kitarë një këngë të qytetit të tij.

Një përshëndetje të veçantë Olsa e mori nga këngëtari i njohur beratas Kujtim Babunja. Salla u ngrit në këmbë për të shoqëruar këngëtarin dhe pas tij edhe Olsën, e cila doli në skenë me një fustan me xixa e me një shami me temina në kokë e cila kur ia thirri këngës betatase, m'u duk sikur dëgjoja në ato, si dikur, të madhin Shyqiri Fuga dhe këngëtarin tjetër popullor Xhemil Saraçi, të atin e Hyrie Saraçit.

Olsa Spata, kjo këngëtare e re, plot energji, me një zë të fuqishëm dhe melodioz, më përtëriu shpirtërisht, më dha jetë, prandaj me zemër i Josif Moksese Olsa! Të këndoftë shpirti siç të këndon goja!"

## BIE POSHT AKUZA PER VRASIE E FOSHJES (Vjerra më akuzoi për të më ndarë nga burri)

Ka mbritur dje nga laborator i kriminalistikes së Ministrisë së Punëve të Brendshme në prokurorin e rrethit Berat pergjegjia e analizave të foshnjes pesë ditëshe e zhvarrosur në datën 24 nëndor '05 në fshatin Lapardha komuna Otllak Nga analizat e kryera në këtë laborator ka rezultuar se foshnja pesë ditëshe nuk është vlarë por ka patur vdekje natyrale, duke rrezuar kështu pretendimin e ish-gjushes së fëmijes dhe njëkohsisht vjerra e Blerinës, Drita Mançe se foshnja ishte vlarë nga bashkëshorti i saj Kadriu në bashkëpunim me nusen e djalit të saj 26-vjeçaren Blerina Mançe. Në këtë menyre bje poshtë edhe dyshimi i 31- vjeçarit Shkelqim Mançe se foshnja mund të ishte vlarë nga bashkëshortia e tij Blerina në bashkëpunim me babain e vet 51- vjeçarin Kadri Mançe. Pas kesaj pergjegje 26-vjeçaria Blerina është shprehur se gjithëçka ka qënë një intrigë dhe shpifje e pa turpshme e vjerres së saj Drita me qellimin e vetëm për ta ndarë atë nga burri i saj Shkelqimi. Zhvarrimi është bërë pas dyshimit të 31-vjeçarit Shkelqim Mançe i martuar para tre vjetësh me Blerina Mançe i cili dyshonte se vajza pesë ditëshe e lindur në muajin korrik të vitit '05, nuk ishte vajza e tij dhe se vdekja e saj nuk ka qënë natyrale por foshnja mund të ishte vlarë nga bashkëshortja e tij Blerina në bashkëpunim me babain e vet 51- vjeçarin Kadri Mançe i cili prej datës 11 nëntor '05 ndodhet në ambientet e komisarjetit të policisë Berat nën akuzën " armbajtje pa leje". Në datë 11 nëntor të vitit '05 shtetasja Drita Mançe pas një konflikti prej rreth dy vjetësh me bashkëshortin e saj Kadri Mançe nga fshati Lapardha ka depozituar përpara oficerëve të policisë gjyqësore në komisarjatin e policisë Berat një akt-padi me anë të së cilës ka akuzuar bashkëshortin e vet Kadri Mançe se një ditë më parë ishte rrahur dhe fyer prej tij dhe se kishte dy vjet që marrëdhëniet e saj me Kadriun i kishte shumë të acaruara duke e iustificuar këtë me faktin se bashkëshorti i saj kishte marrëdhënie intime me nusen e djalit të tyre. Shkelqimin i cili pas martesës së para tre vjetëve me Blerinën kohën më të madhe e

kalonte si emigrant ekonomik me dokumenta të rregullta në Greqi. Për ta bërë më bindëse këtë akuzë Drita e ka akuzuar bashkëshortin e saj Kadri Mançe se ai nga marrëdhënjet intime me nusen e djalit kishte lindur edhe një vajzë në muajin korrik të këtij viti. Vajza ka lindur në maternitetin e qytetit të Beratit dhe në gjendje shumë të mirë shëndetsore por që pas pesë ditësh ka vdekur në shtëpi krejt papritur dhe për këtë ajo akuzon Kadriun se fëmija nuk ka patur vdekje natyrale por është vlarë prej tij në bashkëpunim me nusen e djalit Blerinën. Gjithashtu Drita e ka akuzuar bashkëshortin e saj Kadriun se ai mbante të fshehur në shtëpinë e tij një armë zjarri duke u rrefyer oficerëve të policisë gjyqësore edhe vendin se ku ndodhej kjo armë.


**Policia.** Policia pasi ka dëgjuar pretendimet e shtetasës Drita Mançe po në datë 11 nëntor '05 ka kryer një kontroll banese në shtëpinë e shtetasit Kadri Mançe në fshatin Lapardha dhe në vendin ku Drita kishte treguar se fshihej arma ka gjetur një pushkë dhjetëshe të cilën e ka sekuestruar në cilësinë e provës materiale dhe më pas ka bërë prangosjen e shtetasit Kadri Mançe nën akuzën e " armbajtje pa leje". Policia nuk i ka marë parasysh pretendimet e tjera të bashkëshortes së tij Drita por gjithsesi ka qënë dyshuese për ato që ajo kishte rrëfyer në polici.

Një ditë pas arrestimit të shtetasit Kadri Mançe për armbajtje pa leje ka mbërritur në banesën e vet pranë familjes edhe djalit i bashkëshortëve Kadri dhe Drita Mançe njëkohsisht edhe burri i Blerinës, i cili ndodhej i punësuar në Greqi, Shkelqim Mançe. Ai pasi është njohur me ngjarjen dhe rrëfimin e nënës së tij Drita në datë 12 nëntor ka depozituar pranë prokurorisë së rrethit Beratit një akuzë-kërkesë për zhvarrimin e foshnjes pesë ditësh, pasi edhe ai ka dyshuar se fëmija nuk është i tij dhe se fëmija mund të jetë vlarë nga babai i tij në bashkëpunim me bashkëshorten Blerina. Pas depozitimit të kërkesës dhe akuzës së ngritur nga Shkelqimi prokuroria e rrethit Berat nëpërmjet nje shkrese zyrtare u ka kërkuar ekspertëve mjeko-ligjor në Tiranë që të zhvarrosin fëmija. Dy ekspertë të mjekësisë ligjore prof. Sokrat Meksi dhe dr. Gramoz Ylli kanë mbërritur në fshatin Lapardha dhe në prani të shtetasit Shkelqim Mançe i cili kishte depozituar kërkesën është bërë zhvarrimi i foshnjes pesë ditëshe, janë bërë matjet e

## Bije nga pesëkatëshi, niset në gjendje kome për në Tiranë

Ka qënë duke luajtur me shokët në taracën e pallatit pesëkate ku banonte, por një shaka me shokët e moshës gati i ka kushtuar jetën 11- vjeçarit Altin Azizoll, banor i lagjes "Çlirim", pasi bie nga një larësi më shumë se 18 metra lartësi duke shkaktuar disa fraktura në trup dhe në gjendje kome e kanë nisur me urgjencë në spitalin rajonal Berat.

Ngjarja e rëndë ka ndodhur mbasdite rreth orës 16.30 minuta, kur 11-vjeçari Altin Azizoll ka qënë duke luajtur me shokët e moshës, duke u pohuar shokëve se unë di të fluturoj duke iu afruar boshllëkut në hapësirën e pallatit. Ndoshta ka qënë një tërheqje vëmendjeje apo pakujdesi që pas këtij pohimi fëmija është hedhur nga lartësia dhe ka përfunduar në trotuarin e pallatit në gjendje kome. Për pasojë fëmija ka pësuar disa fraktura në trup. Sipas fëmijve që kanë qënë në vendin e ngjarjes dhe që kanë pohuar për të afërmit e viktimës, kanë qënë ata që kanë bërë tjetër dhe kanë zbritur menjëherë nga pallati për t'i ardhur në ndihmë shokut të



tyre. Por më parë në ndihmë të fëmijës kanë ardhur disa kalimtarë të rastësishëm që janë edhe banorë të lagjes të cilët kanë marrë fëmijën dhe me një makinë të rastit gjendur në vendin e ngjarjes, kanë dërguar atë në repartin e kirurgjisë dhe më pas mjekët e këtij reparti i kanë ardhur në ndihmë duke i dhënë mjekimet intensive.

Sipas burimeve nga spitali, fëmija ndodhet në sallën e operacionit në repartin e kirurgjisë dhe është në gjendje tepër të rëndë për shëndetin. Këto burime kanë pohuar se edhe pse nuk po i mungon ndihma mjekësore, ende fëmija nuk po del nga gjendja e shokut. Në këto

kushte mjekët e spitalit dhe kryesisht të repartit të reanimacionit, pasi kanë parë se gjendja shëndetsore e fëmijës po përkeqësohej nga momenti në moment, kanë vendosur që fëmijën ta dërgojnë në spitalin ushtarak të Tiranës, pasi përmirësimi i shëndetit të tij ka nevojë për një mjekim më të specializuar.

**Policia** dhe ekspertët e saj kanë shkuar në vendin e ngjarjes, kanë kryer procedurat e para ligjore dhe kanë përpiluar dosjen përkatëse për t'ia dorëzuar më pas organit të prokurorisë dhe për të hetuar dhe zbardhur këtë ngjarje, e cila fëmijës vazhdon t'i kërcënojë jetën.

Abidin Kaja

## TENTON TË VETMBYTET 19-VJEÇARJA NË REZERVUAR KU KA HUMBUR JETËN E ËMA

Shënohet rasti i parë i vetësakrifikimit për vitin 2006 në Berat. Ngjarja ka ndodhur në fshatin Gjeroven, komuna Velabisht. Ka qënë afërsisht ora 15.30, kur 19-vjeçaria Avushe Çaçi, pas një zënke me motrën e saj më të vogël, ka dalë nga shtëpia në gjendje depressive dhe i është drejtuar rezervuarit të fshatit, i cili ndodhet afër shtëpisë së xhaxhait të saj ku ajo jeton së bashku me motrën e vogël 16-vjeçare. 19-vjeçaria nga fshati Gjeroven kishte kohë që nuk ndihej mirë dhe shkak për këtë ishte bërë rasti i humbjes së nënës së saj në vitin '94, kur ajo ishte vetëm 7 vjeçe. Nëna e A. Çaçit, pas një gjendjeje depressive, është hedhur në rezervuarin e fshatit ku dhe ka humbur jetën. Pas humbjes së nënës, vajza 19-vjeçare A. Çaçi jetonte prej disa vitesh së bashku me motrën e saj 16-vjeçare te xhaxhai i vet, pasi babai i tyre prej vitesh punon si emigrant në shtetin grek. Pas humbjes së nënës dhe emigrimit të babait, të dyja vajzat kanë qënë nën kujdesin e xhaxhait të tyre në fshatin Gjeroven. Ka qënë babai i vajzave, i cili në pamundësi për t'i marrë ato në shtetin helen, që i ka kërkuar vëllait që për t'ia kujdeset ai. Motra më e vogël e ka ndjekur nga pas atë, por nuk ka mundur ta ndalë që ajo mos të hidhej në rezervuarin e fshatit, i cili ka qënë i mbushur rrafsh me ujë. Me njëherë motra më e vogël ka dhënë alarmin te të afërmit e vet, të cilët kanë mbërritur shumë shpejt në vendngjarje dhe janë hedhur në rezervuar duke e shpëtuar 19-vjeçaren nga "kthetrat" e vdekjes. Vajza është nxjerrë nga rezervuari ende pa u mbytur por gjendja e saj shëndetsore ka qënë e rënduar për shkak të ujit që kishte marrë në rezervuar. Më pas kanë qënë të afërmit e saj që me anë të një makine e kanë dërguar me urgjencë atë në spitalin civil rajonal Berat. Në spital vajza ka mbërritur në gjendje tepër të rëndë shëndetsore, e asfiksuar dhe me vështirësi në frymëmarrje. Sapo ka mbërritur në repartin e urgjencës, asaj i është dhënë ndihma e parë nga ana e mjekëve të repartit të urgjencës duke i nxjerrë ujin nga stomaku dhe më pas është trajtuar me medikamente të tjera për ta nxjerrë nga gjendja e asfiksive si dhe për t'i normalizuar frymëmarrjen. Mjekët e spitalit civil rajonal pohojnë për gazetën se gjendja shëndetsore e 19-vjeçares ka ardhur duke u përmirësuar dhe tani ajo ndodhet jashtë rrezikut për jetën.

A.K.

nevojshme dhe më pas është marrë kampion nga trupi i foshnjes së vdekur me qëllim kryerjen e analizave të nevojshme për të përcaktuar shkaku dhe vërtetë të vdekjes së foshnjes. Pergjegjia e djeshme e analizave për të përcaktuar shkaku dhe vërtetë të vdekjes së fëmijes nga ku ka rezultuar se foshnja nuk është vlarë por ka patur vdekje natyrale e hedh poshtë pretendimin e Drita Mançe se foshnja ishte vlarë nga burri i saj

Kadriu në bashkëpunim me nusen e djalit. Shtetasi Kadri Mançe aktualisht ndodhet në burg për veprën penale të armbajtjes pa leje dhe me përgjigjen e djeshme të këtyre analizave atij i ngelet vetëm akuzë e "arme mbajtje pa leje" duke u hedhur përfundimisht poshtë akuzat tjetër e ngritur nga bashkëshortja e tij Drita për "vrasje në bashkëpunim" me nusen e djalit Blerinën të foshnjes pesë ditëshe.

A.K.


# Krijohet këshilli rajonal i (PAK) për prefekturën e Beratit

Në datën 27 dhjetor 2005 në një mjediset e pallatit të kulturës "Margarita Tutulani", zhvilloi punimet konferenca e parë kombëtare rajonale për personat me aftësi të kufizuar (PAK) për prefekturën e Beratit.

Kjo konferencë pati dy synime kryesore: e para, ishte njohja me strategjinë kombëtare për (PAK) dhe e dyta, do të zgjidhte këshillin kombëtar rajonal për (PAK) në prefekturën e Beratit. Në këtë konferencë merrnin pjesë kryetarja e Internacionales Kombëtare për Evropën Juglindore, znj. Merita Pone, kryetar i përgjithshëm i invalidëve të punës z. Avdulla Omuri, president i shoqatës paraplegjike dhe tetraplegjike, z. Ndrek Ismaili dhe kryetar i shoqatës "Ndihmoni jetën", z. Bashkim Seiti.

Në këtë konferencë, e cila zhvillohej për herë të parë në qytetin e Beratit, merrnin pjesë katër shoqatat më kryesore, të cilat ishin shoqata e invalidëve të punës, e paraplegjikëve, e të verbërve dhe ajo e handikapatëve.

Të gjitha këto përfaqësueshin nga drejtuesit e tyre dhe nga dy persona të paafte për çdo shoqatë respektive. Fillimisht e mori fjalën znj. Merita Pone, e cila, mbasi na njohu me strategjinë kombëtare për paafte të tilla tha se për hartimin e kësaj strategjie është dashur një kohë relativisht e gjatë në të cilën ka punuar një grup pune i përbërë nga ekspertë të ndryshëm të disa ministrive dhe nga shoqëria civile dhe e gjitha kjo u mbështet nga Zyra e Komisionit të Lartë Federal për Çështje të Personave me Aftësi të Kufizuar, ministria Federale e



Petrît Muçogllava


Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale Republika Federale e Gjermanisë dhe me prezencën e OSBE-së në Shqipëri. E gjithë kjo paketë ligjesh është bazuar në legjislacionin gjerman. Prandaj për të arritur këtë, është dashur një punë shumë e madhe nga ana e shoqatave dhe është bërë presion i vazhdueshëm mbi qeverinë.

Më pas, z. Merita Pone tha se ne jemi pjesë e kësaj shoqërie dhe duhet të marrim atë që na takon, sepse dikur i kemi dhënë asaj dhe jo të sillemi si lypsarë. Gjë që s' do ta pranojmë askush prej nesh.

Në hartimin e kësaj strategjie është krijuar dhe komiteti ndërministror i punës, i cili do e ndjekë në vazhdimësi këtë strategji. Midis të tjerash, theksoi znj. Pone, se qeveria e z. Sali Berisha e ka marrë seriozisht këtë çështje dhe u ka vënë detyrë ministrive përkatëse që të angazhohen maksimalisht, sikurse është përcaktuar në të. Sepse kjo është detyra jonë dhe jo kolltuqet e ngrohta.

Nga kjo strategji do të përfitojnë të gjitha PAK që kanë qenë jashtë këtij statuti dhe s'kanë patur mundësi për t'u integruar njëjloj si gjithë të tjerët. Gjithashtu po përgatitet dhe ligji higjienik dhe i pajisjes së PAK me mjete lëvizëse. Kështu të gjitha këto bëjnë pjesë në strategjinë kombëtare.

Ndërkohë, zbatimi i këtij projekti do të monotirohej nga Banka Botërore dhe FM-ja, të cilët të gjithë kanë ardhur në vendin tonë dhe kanë bërë një sondazh në



disa rrethe duke marrë mendimin e disa njerëzve të thjeshtë.

Po kështu është hedhur ideja e ngritjes së një qendre spitalore për fizioterapi dhe personave me aftësi të kufizuar, i cili do të ngrihet në një nga qytetet veriore në atë të Kukësit dhe kjo u vendos për arsye se ky është nga qytetet më problematike të vendit. Pasojë e së cilës ka qenë lufta e Kosovës ku shumë njerëz kanë ngelur të gjymtuar nga minat e vendosura nga ushtria serbe, të cilat sot e kësaj dite po marrin jetë njerëzish.

Më pas u kalua në problemet që na shqetësojnë në këtu në qytetin tonë. Të gjithë qenë të një mendimi. Problemet kryesore ishin infrastruktura, strehimi dhe ambientet për aktivitetin e këtyre shoqatave.

Për të gjitha këto ramë në një mendje që të bashkohemi si një ansambël i vetëm në mënyrë që të sensibilizojmë mbarë shoqëria që të kuptojnë se kanë detyrime të mëdha karshi kësaj shtrese tejet të diskriminuar.

Gjithashtu u shtrua me të madhe që të ndërhyet në të gjitha ndërtime të reja në mënyrë që t'i përshtaten kësaj kategorie dhe jo nesër të fillohej për të prishur ato sepse do të na kostoje shumë.


Në fund të kësaj konference u bënë zgjedhjet për në këshillin kombëtar për prefekturën e Beratit. Kryetar u zgjodh

z. Ali Kandarxhi, n/kryetar z. Gëzim Lavdari dhe anëtarë u zgjodhën znj. Marie Shehu dhe z. Petrit Muçogllava.

Në fund miqve të ardhur nga Tirana iu shtrua një drekë në një lokal në periferi të qytetit të Beratit. Së fundi në emër të të gjithë invalidëve të Beratit dua të shpreh mirënjohjen time të thellë dhe t'i jem mirënjohës drejtorit të pallatit të kulturës, z. Kadri Kuka, i cili na bëri të mundur zhvillimin e këtij aktiviteti kaq të rëndësishëm duke na vënë në dispozicion një mjedis mjaft të përshtatshëm për ne.

## Burg pa afat vrasësit të vjehrrit

Është zhvilluar rreth orës 10:30, në gjykatën e faktit Berat seanca gjyqësore për vlerësimin e masës së arrestit në ngarkim të shtetasit Erion Mujollari, i cili në datë 07.01.06, pasi dhunoi dhe shtrëngoi për bashkëjetesë për disa orë ish-bashkëshorten e vet Nertila Lala në shtëpinë e ish-vjehrrit Safet Lala, e qëlloi këtë të fundit me tre plumba në gjoks duke i shkaktuar atij vdekjen e menjëhershme. Trupi gjykues i kryesuar nga gjyqtarja Velçani ka pranuar kërkesën e prokurorës së çështjes Ermonela Felahi dhe ka vendosur masën e dënimit burg pa afat për ish-dhëndrin vrasës, me qëllim hapjen rrugë hetimeve të mëtejshme të ngjarjes



makabër të ndodhur në periferi të lagjes "Kushtrim". Erjon Mujollari, i cili e ka pranuar akuzën e vrasjes të ish-vjehrrit të vetë Safet Lala, do të hetohet për veprat penale: vrasje me paramendim e parashikuar nga neni 78 i KP; armëmbajtje pa leje parashikuar nga neni 278/2 i KP; shtrëngim për bashkëjetesë, parashikuar nga neni 130 i KP. Për mbrojtjen kryesisht të Erion Mujollarit është caktuar nga gjykata e faktit Berat avokat Astrit Skëndo. Në seancën e djeshme për vlerësimin e masës së arrestit 25-vjeçari Mujollari nuk ka pranuar të flasë me pretendimin se do të flasë vetëm kur si avokat mbrojtës ai të ketë një person tjetër të zgjedhur nga familjarët e tij.

Abedin Kaja

## Vidhet zyra e komunës, identifikohet autori

Janë vjedhur në orët e vona zyrat e komunës Terpan, rreth 22 km larg nga qyteti i Beratit. Me sa duket vjedhësit e kanë studiuar dhe përcaktuar më parë strategjinë e vjedhjes dhe për rrjedhojë nuk e kanë patur të vështirë të marrin materialet e parapercaktuara. Objekti kryesor i vjedhësve në zyrat e komunës Terpan sipas burimeve policore ka qenë arka e lekëve të kësaj komune. Por, fatmirësisht, ajo ka rezultuar bosh. Më pas ata kanë vjedhur një aparat fotokopjeje dokumentash me një vlerë prej 130 mijë lekë, blerë para një muaji dhe që e përdorte administrata e komunës për fotokopje dokumentash. Por vjedhësit nuk janë mjaftuar me kaq. Për ta bërë edhe më "mirë detyrën si dhe për ta justifikuar sakrificën e vjedhësit, prerjes së kyçit dhe futjes në objekt", kanë marrë të gjitha mjetet e tjera të kancelarisë që ndodheshin aty, si blloqe, fletore, bojra, etj, por me një vlerë më të vogël monetare se sa aparati i fotokopjimit. Vjedhja është konstatuar rreth orës 07:30 nga kryetari i komunës Engjëll Velia, i cili shprehet për gazetën Lajmëtari: "Shkova si zakonisht në punë dhe pashë nga larg derën kryesore të zyrës së komunës hapur dhe për një çast mendova se atë do ta kishte harruar ndonjë punonjës i administratës. Por kur shkova

pranë, pashë se kyçi ishte i hedhur përtokë dhe ishte prerë me sharrë hekuri. Pasi u futa brenda, konstatova se ishte vjedhur aparati i fotokopjes me një vlerë prej 130 mijë lekë si dhe mjete të tjera kancelarie që ndodheshin në zyrat e administratës së kësaj komune".


Kryetari i komunës Terpan Engjëll Velia menjëherë ka depozituar në komisariatit e policisë një kallëzim penal për këtë vjedhje. Në vendngjarje ka shkuar një grup i agentëve të policisë kriminale, i kryesuar nga shefi i këtij seksioni, z. Edmond Selamaj. Pas marrjes së informacionit të nevojshëm, ata kanë bërë të mundur identifikimin e autorit, i cili rezultoi të jetë 30-vjeçari T.A., banor i fshatit Rehovë, komuna Terpan, i cili aktualisht banon në qytetin e Urës-Vajgurore, i dënuar më parë për krimine plagosjes së rëndë dhe për vjedhje. Vjedhja e zyrave të komunës është kryer me makinë dhe më pas autorët e vjedhjes këto materiale i kanë shitur me një vlerë minimale në njërin prej njësive të shitjes të qytetit të Ura-Vajgurore. Më pas është bërë sekuestrimi në cilësinë e provës materiale i këtyre objekteve të vjedhura. Po punohet për zbulimin e vendndodhjes dhe vënien në pranga të autorit.

A.K.

## Një shqetësim i drejtë Vërtet, ku kanë përfunduar kostumet?!


Në një emision të fundvitit në "Onufri Televizion", një intelektual i qytetit tonë, por që nuk rri më në Berat, por me mendje e zemër është natë e ditë këtu, shtroi një problem, që patjetër kërkon përgjigje nga ata që e kanë patur një detyrë që të ruajnë dhe administrojnë kostumet kombëtare të Beratit, jo vetëm të qytetit, por dhe fshatrave të tjera. Mbledhja dhe ruajtja e këtyre kostumeve është meritë e padiskutueshme e "babait" të muzeut, të ndjerit Todi Sotiraj, i cili vdiq siç nuk e meritonte asnjë qen, që do të kishte ruajtur të paktën për disa vjet një "derë të shtëpisë" që quhej shtet. Pa u futur te hallet e intelektualit beratas, për kostumet, dua t'i kujtoj një gjë: meqë kanë hartuar një listë me njerëz dhe nga më të rëndomtit për t'u nderuar me tituj "Qytetar Nderi" apo "Nderi i Qytetit" (ai i profesionit për të cilën janë paguar), i bëj thirrje që nëse e kanë harruar të madhin Todi Sotiraj, që u burgos për shkak se zbuloi kurvëritë e qeveritarëve e partiakëve (të disa prej tyre), ta shënojnë në krye të listës jo vetëm se e meriton, po se është i panjeri e i papërkrahur. Zotërinj, meqë keni shoqëri e miqësira nga të dyja anët e politikës, se nuk i thonë kot qengji i mirë nuk pi jo vetëm dy nëna, po tërë kopenë, bëni çmos dhe kujtojuani

atyre që drejtojnë qytetin, por që kanë ardhur vonë në Berat. Ka qenë një banor i lagjes "13 Shtatori" (mbi bankën e sotme), që kishte vetëm një nënë, që nuk kishte vëlla e motër, por kishte një "fëmijë" që e lindi dhe e rriti vetë, por që nuk e lanë ta gëzonte, që quhej "Muzeu i Beratit". Dhe duhet ta pranoni se ka qenë një nga muzetë më të pasur e më të organizuar të vendit. Todi Sotiraj e la muzeun plot e përplot me relike e me objekte, të të tëra kohërave. Todin e futën në burg. Doli nga burgu e çuan në punë krahu e më pastaj në azil në Fier ku dhe vdiq. Ata që erdhën pas Todi Sotirajt, duhet ta dinë e të përgjigjen për humbjen e këtyre vlerave të pallogaritshme. Zotëri, ju duhet ta dini, se gjysma e anëtarëve të shoqatës suaj, në kohën e diktaturës, por dhe të tranzicionit, kanë qenë njerëz me poste e me përgjegjësi, por kanë qenë dhe me njohje me persona që kishin dijeni se ku kanë shkuar kostumet. Jo pak nga ju kanë qenë duke kaluar "kohërat e rrezikshme" aty nga fqinjia ynë jugor. A nuk i ka rënë në sy ndonjërit aty rreth e rrotull Janinës, ndonjë që shiste jo vetëm ikona, por relike të tjera? Meqë jeni shoqatë me njohje të thella dhe keni marrë përsipër të bëni gjithçka për Beratit, futjuni njëherë kësaj "ferrës" së vogël të humbjes së



kostumeve, se mos del ndonjë lepur i madh. Ta duash e të bësh për qytetin tënd janë dy gjëra. Tani keni në dorë të gjeni se ku kanë përfunduar ikonat, reliket, objektet historike bashkë me to dhe kostumet kombëtare. Sikur t'i gjeni e meritoni komplet si shoqatë të merrni titullin "Qytetarë të devotshëm të Beratit". Shpresoj se sadopak ju kam treguar se nga duhet të niseni për të gjetur atë që kërkoni.

Do të ishte në nder jo vetëm të kulturës beratase, por dhe të lagjes ku lindi e banoi Todi Sotiraj, por dhe për tërë qytetin e Beratit, që rruga ku ndodhet shtëpia e tij, ose një pavion në



### A përfaqëson zërin e popullit gazeta e Erion Braçes?


Ka qenë dhe është një nga datat kryesore për një gazetë vendosja e emrit të saj. Vendosja e emrit të gazetës, është si puna e venies së emrit të fëmijës, prandaj kërkonjë emër të bukur dhe domethënës. Kështu ka ndodhur dhe me gazetën e komunistëve të Shqipërisë, kur e nxorën në kohën e luftës. Emrin ia vunë si emrin e një gazete komuniste italiane: "Voce del popolo". Dhe atëherë ishte një emër propagandistik e nuk përfaqësonte të vërtetën. Vërtet nga shtresat e varfëra të popullit kishte shumë komunistë, ashtu siç kishte edhe shumë ballistë, zogistë, socialdemokratë dhe fashistë. Pra, komunistët nuk ishin i gjithë populli. Gjatë kohës së diktaturës as që i shkante njeriu ndër mend që të ndryshonte emrin e gazetës, që në emër të popullit (lexo partisë) kishte shtypur e torturuar, internuar e burgosur një popull të tërë. Të paktën në vitin 1992 kur ish- komunistë u mundën keqas nga vota e sovranit, duhej që patjetër të kishin ndërruar emrin e gjenjesh të gazetës. Por heshtën si "KQPS" (kryesia dhe KPD e famshme). Por jo! Ish-komunistët deshën t'i tregonin veteranëve që nuk ndaheshin dot nga Enveri, se ata ishin po ata, nuk kishin ndërruar përveç emrit të partisë, nga e Punës në atë Socialiste. Të dalësh sot në tregun mediatic me një gazetë me një emër që nuk përfaqëson as 30% të popullit është si të ngopesh me lugë bosh. Është e drejtë e cilido që nuk e shikon veten simpatizant apo anëtar të PS-së që të protestojë për shfrytëzimin e tij, për të shitur një gazetë që shtet gjithë ditën e perëndisë gjëra të pavërteta, gjenjeshtra me bisht. Drejtuesit e gazetave duhet të bindin Erion Braçen se gazeta e tij nuk është gazeta e 3 milionë shqiptarëve. Duke përjashtuar demokratët, republikanët, ballistët, legalistët, socialdemokratët ata të LSI-së, PAA e Xhuvelit, Starovës, të Milos e të 70 të tjerëve, Erioni duhet ta dijë se sa njerëz mund të përfaqësojë ajo gazetë.

Dhe më e madhja është se sa vetë e lexojnë. Sa nuk është vonë, le ta mbajë si relike të së kaluarës Hysni Millosi, i cili me pastërti prej militanti pranon se nuk ka ndryshuar nga e kaluara, që kur e

Tre vjet të qeverisjes së atij të parit dhe dy vjet të këtij të dytit, në krye të bashkisë së qytetit tonë, Viti i Ri është festuar më shumë me urdhër dhe me makinacione për të treguar lumturinë e bollëkun se sa të shtyrë nga nevoja për të harxhuar kursimet e varfëra. Të dy vjetët e këtij burrit që e zëvendësoi, tërë dyqanet e qendrës urdhëroheshin që të rrinin hapur nga mëngjesi në mëngjes. Në tabien e Kalasë, në Shën Thanas, andej nga Bregu, nga Sheshi i Dosave, nga Lëmi i Shamatasë, nga çdo lartësi, repartet ushtarake bënin shkrehjen e fishekzjarreve, që pasoheshin dhe me ndezje fishekzjarresh nga qytetarët, por dhe ndonjë breshëri kallashi nga militantët, që i gëzonin vendit të punës, pa shkollën përkatëse. Të gjitha këto përktheheshin si "gëzim e lumturi", si "falënderim i qytetarëve për qeverinë që ia kishte bërë jetën parajsë".

Drejtorja e kulturës, ca me aktorët e vet, ca me borxhe nga qytete të tjerë, por që i paguante sa frëngu pulën, i ftonte qytetarët beratas të mbushnin sheshin. Shkonin dhe nëpër lokalet, që urdhëroheshin të rrinin hapur. Po këtë vit, përse vallë

### Për kë mbajti zi bashkia jonë?



ndryshoi taktika? Përse ndryshoi mënyra e festimit? Përse nuk pati koncert? Përse nuk u urdhëruan dyqanet të rrinin hapur? Përse nuk u hodhën fishekzjarre nga pikat dominuese të qytetit? Për kë mbajti zi bashkia e qytetit?

Një gjë të binte në sy këtë vit. Kudo që drejtojnë partizanët e ylberit të Edi Ramës, nuk pati festime. Kjo gjë duket dhe kuptohet që është bërë me urdhër nga kryetari i mëmës bashki dhe i nënës parti. Socialistët kudo që drejtojnë janë në zi. Ata po qajnë kohët ku për një thellë të shpenzuar kërkohet dhe raportoni

se kishin harxhuar një pelë. E po tani ka babai biçak e nuk të lë të bëhesh hovordar me lekët e taksave të popullit. Sado që socialsitët dhe mediat e tyre duan që t'i errësojnë festimet e këtij viti, nuk e bëjnë dot. Mjaftonte të shikoje nëpër furra se këtë vit kishte më shumë tepsi me kaponj të therur se sa me kofsha pule. Kjo tregonte se dhe propaganda bajate komuniste për t'i prezantuar ditët e para të qeverisjes si të dështuara, nuk ia arritën qëllimit. Diversioni dhe sabotimi i energjisë nuk i doli në kut. Viti i Ri u festua me drita pa ndërprerje. Edi Ramës i dhimbnin sytë, ndaj iku në Amerikë. Po kështu dhe mjaft socialsitët të tjerë nuk i bënë në vend festat. Sado që bashkia nuk bëri asnjë organizim për festat, populli uroi me gojën plot: "shyqyr që na ikën hajdutët e mëdhenj, se këta të vegjlit i bëjmë kollaj zap!" Sa do që mediat e lidhura me fije të dukshme e të padukshme me PS-në, shkrehjet e fishekzjarreve i krahasonte si "luftë" që na i kujtoca 97-ën, ndërsa një vit më parë dhe shkrehjen e kallashëve i kallëzonte si shpaloje e qytetarisë dhe e gëzimit qytetar. E po më servilë e të padrejtë se kaq nuk ke se ku gjen, ku rreh këmba e kalit atje ndodhen. Vetëm socialistët dhe soja e tyre as skuqen e as verden kur gëniejnë, trillojnë e mashtrinë ashqarë.


Mbajti zi? E mbajti për kokën tuaj!

## Po na dha qeveria para, do bëjmë namin këtë vit

Pak a shumë kjo ishte ideja e fjalës së kryebashkiakut në intervistën dhënë gazetares së "Onufri Televizion" për projektet e punëve që do të bënte bashkia në tërë aktivitetin e saj. Nga fillimi e gjer në fund të fjalës së tij, zoti Nasufi, nuk harroi të thoshte: "Në qoftë se do të na sjellë fonde qeveria!" Zoti Nasufi harron se dhe njerëz të tjerë dinë të lexojnë dhe kanë dhe radio dhe televizion dhe marrin vesh se ç'bëhet në Tiranë e ç'thuhet në Kuvend. Në buxhetin e ri të vitit, qeveria e ka rritur ndjeshëm fondin që u jep pushteteve vendore, madje ajo i ka lënë një pjese shumë të madhe të taksave vendore, që t'i përdorë për nevojat e qytetit, si t'i ketë planifikuar ato. Ai nuk thotë se çfarë taksash mbledh nga taksat vendore. Ai nuk thotë se sa lekë ka mbledhur gjatë vitit që shkoi dhe se ku u përdorën e për çfarë u përdorën ato. Bashkia e Beratit është mësuar që të marrë çdo vit fonde jo të vogla nga qeveritë socialiste, fonde që bënin firo të ndjeshme pa ardhur akoma në Berat. Janë me dhjetëra fondet që janë dhënë, por që nuk "kanë dalë" për punët e planifikuara, sepse fondi është tretur rrugës që nga Tirana deri në destinacion. Kështu ishte ndërtuar ai shtet, që shqiptarët e hoqën qafe me votën e 3 korrikut e jo me kallashet të vjedhur nëpër depot që hapën oficerët militantë të partisë socialiste. Pra, që në burim të dhënies së fondit, një pjesë jo të vogël e donte ai që do të siguronte se kujt do t'ia jepte fondin, pra, donte një pjesë nga firma që do të "fitonte" tenderin (që ishte i paracaktuar, jo rrallë dhe me ndonjë shok a mik të djathtë, por që për ideal nuk kanë idetë e nevojat e popullit, por lekun që nuk ka as parti e as ideal), kur shkante të firma që do të bënte punimet, dihej se sa ngelte trasta e dhënë nga qeveria dhe firma bënte hesapin e saj se sa do të fitonte nga fondi shtataniq që ngelte dhe e gjente zgjidhjen, punë me cilësi të dobët se nuk e kontrollonte kush. Janë me dhjetëra punimet në rrugë, trotuare, shkolla, objekte sociale që e dëshmojnë këtë. Shikoni rrugët si kanë përfunduar! Shikoni trotuaret se sa gropa e pllaka që lëvizin e të thyera kanë! Shikoni lulishtet e pambaruara, shikoni qendrat shëndetësore se si janë bërë (model i veçantë që ka kushtuar 56 milionë lekë ose 60 milionë lekë, gjithnjë të vjetra sa një

kotec në lagjen "D. Kastrioti"! Shikoni shkollat, shikoni meremetimet e palestrave, shikoni fushën e futbollit! E ç'të shikosh më parë që të kuptosh se si kanë avulluar fondet e dhëna?! Më keq se fondet e dhëna nga qeveria shqiptare, kanë përfunduar fondet e dhëna nga të huajt. Kujtoni se në zgjedhjet e vitit 2001 rrugës që të çon te Rezidenca e motrave katolike Santa Lucia Pie Filipini, iu hoqën shtyllat e planifikuarat nga 10 m për këtë rrugë dhe u shkullën në një rrugë ku të çonte te të afërmit e ish-deputetit të asaj lagjeje, e jo pak, por 19 shtylla e lanë rrugën që të çonte te kisha e shkolla e kopshti "Ylli i Mëngjesit", sepse duhej bërë politikë me lekët e botës që na i jepte ne, që t'i bënim punët pa hile dhe ashtu siç duhet. Tani duam të dimë, sa e ka planin bashkia që të vjelë taksat e qytetarëve? A do t'u mbledhë tërë qytetarëve njëllor apo disave do t'ua marrë e disave nuk do t'ua marrë? Gjatë këtyre 8 vjetëve ka patur plot. A do të dorëzojnë tërë paratë e mbledhura nëpër dyqane taksambledhësit, apo do t'i ndajnë me "bejlerët" e bashkisë? A do të bëjë transparencë bashkia se sa taksa mbledh në vit nga qytetarët dhe përse i mbledh, por më kryesorja ku i harxhon dhe si i harxhon këto taksa? Ndërsa dëgjuam nga kryebashkiaku se çdo të bëhet me paratë që "nëse do t'i dërgojë" qeveria, apo me ato që do të sigurohen nga donacionet e huaja apo nga BB, nuk dëgjuam se si do të përdoren taksat që do të mblidhen nga çdo qytetar e çdo familje. Qytetarët beratas shpresojnë te transparenca e kryetarit të bashkisë se ai në një prononcim jo vetëm në televizion, por dhe me një panel qytetarësh e me përfaqësues të medias tregoi se si do të kollondrisen taksat këtë vit.

Berati ka shumë halle dhe kërkesa, por ka dhe shumë plane e projekte, këto duhen bërë biseda me zgjedhësit e jo të mbyllura, ku mund të luhen lojëra të pandeshme. Qeveria jonë është bashkia. "Kryeminsitri" ynë, kryetari i bashkisë, parlamenti ynë është këshilli bashkiak, ndërsa ne kërkohet nga secili veç e veç dhe nga të tërë së bashku, të plotësojnë angazhimet e marra, kur kanë dashur të bëhen përfaqësuesit tanë. Ikën ato 8 vjet që u luajt harshash në kurrizin tonë. Tani pyeteni me nderen mirë kur të kërkoni e të harxhoni lekët e taksave tona.



Elham Pasha

# Katmanduja e trakteve

Babru, ku kishte mësuar dhe një shqipe të çalë.

Indiani ishte i shqetësuar se dy ditë më parë e kishin kërcënuar me një letër hedhur në dhomën e tij të banimit. Letra ishte pa adresë...

"Kjo letër të kujton traktet e rebelëve maoistë të Nepalit, veçanërisht në Katmandu", thotë indiani i shqetësuar dhe i fyer nga njerëzit e vendit të Nënë Terezës.

Ecim më tej në komentin tonë.

në ekstrem. Ato pësojnë metamorfozë sipas "ngjitjes" dhe "zbritjes" të pushteteve të ndryshme.

Letrat pa adresë mbeten regresi më famëkeq i shqiptarizmit edhe në demokraci.

Shumë njerëz goditen padrejtësisht, me anën e këtyre letrave, ku, autorët e tyre kanë thjesht interesa xhelozie e meskiniteti. Shpeshherë këta letërshtues bëhen "bombë" me pagesë edhe

morali dhe askush s'i cilëson subjekt i së keqes.

Shpesh viktima të kësaj infrastrukture keqësie bëhen njerëzit punëtorë e të ndershëm, veçanërisht femrat me dinjitet e risi guximi. Kapitalizmi antihuman shqiptar pjell lloj-lloj traktesh, direkt, dëmtuese e denigruese deri dhe në ekstrem. Ndoshta është koha që kjo katmandu e gjithanshme shqiptare kërkon infrastrukturë të re morale dhe ligjore, pse jo guximin dhe sakrificën e të dëmtuarëve.

Shumë konflikte e grindje familjare, apo divorcime të ndryshme edhe në hapësirat e Beratit, realizohen nga intrigat dhe thashethemet, që në rrethana të veçanta merren edhe si subjekt i një "katmanduje" gjoja reale.

Varfëria shqiptare dhe politika konfliktuale sjellin vazhdimisht të tilla mjedisë të papëlqyera. Është detyra e të gjithëve, veçanërisht e shoqërisë civile dhe e medias që të zbulojnë e të dënojnë publikisht këtë "katmandu traktesh" shqiptare.

Shpesh konsumet politikës të opozitës, nuk i ofrojnë popullit realen, por oportunitetin artificial dhe faktin ireal me fytyra hipokrizie të neveritshme.

Neokomunizmi ende është primarja e shoqërisë tonë. Komunitete të tëra njerëzish bien viktimit e këtij morali narcist. Shumë njerëz bëhen "kurban" të liderëve, që s'e duan kurrë interesin masiv të popullit, por vetëm atë ç'ka është "katmandujane" e klanit të tij!

Pra, pa kuptuar, kthehemi "kamikazë" apo "kollonë e pestë" e minipakicës që prodhon vetëm regres demokratik.

Ne, shpesh, verbërisht, thërrasim "rroftë mbreti" kur ai na

Nëse kemi vite që jetojmë lirinë demokratike pa pushtues e diktatorë, prapë kemi frikë nga liria... Kjo është më e rrezikshmja, dhe më enigmatikja e shoqërisë sonë. Ne ende s'e kemi ndjerë terrorizmin... (Dhe mos e paçim fat kurrë!)

Po politika e molepsur nga antikulturat globale dhe mendësi të tjera regresiste, apo jo profesionale, sjellin shumë trakte, natyrisht jo ato të tipit katmandujan, por të sfondit të neveritshëm shqiptar me dekore e grila komuniste apo të demokracisë anarkiste.

Kjo ndodh se shoqëria jonë ende nuk është e filtruar nga e kaluara me xheloz, karrierizëm, zhvatje e spiunime. Mungesa e kulturës së mirëfilltë demokratike, apo e ligjit me risi shenjtërie e profil të plotë drejtësie

Ky peizazh politik e social shqiptar pjellë lloj-lloj "trakte" ilegale dhe legale, të cilat provokojnë së tepërmi strukturën dhe psikologjinë e demokracisë sonë.

Këto trakte ravijëzojnë në forma të ndryshme në Shqipëri, shpeshherë kriminale deri

për të tjerët, të cilët s'dalin kurrë ballë për ballë... Letra të ritualit të tillë mbërrijnë shumë nëpër intitucione apo titullarëve të pushtetshëm. Shpeshherë këto "trakte" i hartojnë apo i dërgojnë militantë partishë, karrieristë dhe njerëz me vese, shumë herë edhe për përfitime personale.

E keqja e tyre, jo në pak raste, qëndron se institucionet apo titullarë të ndryshëm, bien viktimit i letërshtuesve ilegalë dhe pa adresë.

Pra, liria, mund totalisht lirinë e mirëfilltë demokratikë, duke krijuar një lloj nuance terrorizmi edhe për njerëzit me shumë vlera, apo revanshe për anarki institucionesh apo ligjore.

Shpeshherë këto letra të injorojnë dhe të denigrojnë deri në dëmtime të rënda, por në shoqërinë tonë ky lloj abuzimi ilegal, s'përfillet aspak! Këtu qëndron e keqja e moralit tonë kolektiv dhe individual, që siç folëm edhe më lart sjell pasazh edhe për anarki. Edhe thashethemexhinjtë hyjnë në principet e këtij

## Zoti kryetar i bashkisë, a e dini se për çfarë ka nevojë sporti?


Në veprimtarinë për shpalljen e fituesve të anketës sportive për vitin 2005, isha i ftuar dhe unë nga bashkia e qytetit. Ju them sinqerisht, më erdhi shumë keq në fillim, kur nuk shkova dot, sepse vetëm një orë përpara, kur isha nisur për në lokal ku do të bëhej aktiviteti, pata një goditje shumë të lartë tensioni arterial, gjë që e bëri të pamundur pjesëmarrjen time, por që e ndoqa nga ekrani i "Onufrit". Ju them pa keqardhje, më mirë që nuk shkova! Ja sepse: në atë sallë ishin mbledhur më shumë për të ngrënë e për muhabete, se sa të dëgjonin arritjet dhe kërkesat e sportistëve. Qytetarët beratas një gjë duhet ta kenë kuptuar, se sporti nuk njih partira dhe ide, sepse ajo mbrëmje e thejshë kishte bashkuar partiakë me bindje të ndryshme, ku dhe i trokitën gotat e nuk u shanë apo nuk akuzuan njëri-tjetrin për të tërë të këqijat që po kalojmë dhe sot. Thashë më mirë që nuk isha, sepse nuk do të kisha qëndruar asnjë minutë kur gazetari intervistonte fituesin e radhës të sportit përkatës, në çdo tavolinë bëhej pazar, si në pazarin e qelbur të Urës së Goricës. Asnjë nuk e respektonte personin që intervistohet, pavarësisht nga mosha. Secili duhej të kuptonte se ishin pikërisht këta 13-14-15 e 20-vjeçarë si dhe trajnerët e tyre 40-50-vjeçarë që i mblodhën pikërisht këta burra e gra pushtetarë e qeveritarë, të cilët dhanë dhe okej për këtë veprimtari, por për fat të keq nuk i dëgjuan se ç'thanë. Sinqerisht më vjen mirë që bashkia këtë vit u kujtua të bënte atë që ish-komiteti ekzekutiv e bënte çdo vit. Një shkak që këto soj aktivitetesh nuk bëhen, është se "ujemi" që tepron për atë që ka dhënë "gjeteth jeshile" është zero, ose i papërfillshëm. Sportistët, trajnerët, drejtuesit e klubit, drejteusit shtetërorë e pushtetarë u mburrën me këta djem e këto vajza (megjithëse që vetëm një, por me meritë ama, e jo si vitet e tjera që vlerësohej e kaluara, se mos i negej qejfi sot), madje u qanë dhe hallin se kanë arritur rezultate të larta në kushte të këqija stërvitjeje. Po të isha në koktejl dhe shtruar nga bashkia, me siguri si tërë ata që ndanë vlerësimet për çdo sportist, do të kisha folur dhe unë. Meqë nuk isha, do të kisha thënë po këto, që do të rendis më poshtë. S'kam ç'të bëj, e kam këtë huq, atë që e ndiej dhe e mendoj, dua ta them e të mos e mbaj përbrenda.

Ja ç'do të thosha.

Pasi të uroja fëmijët e të rinjtë, por dhe trajnerët e tyre, do t'ui kujtoja qeveritarëve e pushtetarëve se nuk është hera e parë që premtojnë e nuk e mbajnë fjalën! Do t'ui kujtoja anëtarëve të këshillit të bashkisë, pa harruar drejtuesit e partive (sidomos ata të dy më të mëdhenjtë), se ky qytet, që përgatitet të merret nën shtetullat e UNESCO-s, në infrastrukturë është një zero me bisht. Nuk është as në qiell e as në tokë. Do t'ui kujtoja dhe një shoqate që "qan" e çirret, çdo ditë për Beratin", se në gjirin e vet ka milionerë shumë të fuqishëm që nuk do ta kishin për gjë, sikur dy ose tre prej tyre të merrnin përsipër që të sjellin në gjendje normale, secili nga një mjedis stërvitjeje. Këta milionerë që ushtrojnë aktivitetet në Tiranë, por zemrën e "kanë në Berat" ashtu siç fitojnë dhe tenderat po në Berat, mund të bashkohen dhe dy e tre së bashku, as që do t'i ndiejnë fare ato dy-tri qime, që do të shkulin nga shteti i tyre leshtor. Si pushtetarët, qeveritarët, milionerët beratas duhet ta dinë se sportistët nuk kanë nevojë vetëm për çibukë, kikirika, fanta, bajame e lajthi, por në radhë të parë për kujdesje që të stërviten si shokët e tyre kudo në Shqipëri e sidomos në Evropë e në botë.

Zotërinj, dua t'ju kujtoj njaj dy fakte që po t'i analizoni me dashamirësi, do të më jepni të drejtë. Q nga viti 1990 e deri më sot vetëm në zyrën e kreut të bashkisë janë ndërruar 5 titullarë. Secili prej tyre i ka hequr dhe i ka shtuar diçka të re zyrës së tij, ku do të ushtronte aktivitetin. Kanë bërë ndryshimet dhe kur nuk kanë qenë të nevojshme, po kështu kanë bërë dhe shefat e drejtorët e drejtorive të ndryshme, vetëm e vetëm (jo vetëm për këtë, por dhe për një çështje tjetër), që të harxhonin fondin, që shtet kodoshi i merr nga taksat tona dhe ua jep kodoshëve të tij, që t'i bëjnë rrush e kumbulla. Vetëm këto fonde sikur të harxhoheshin çdo vit për një mjedis sportiv, palestrat tona nuk do të ishin në këtë gjendje. Me siguri që keni marrë angazhime pas atij daveti që shtruat për sportistët. Me siguri që jeni zotuar se do t'i rregulloni. Të presim e të shpresojmë. Po kam frikë kush ka gënjer një herë, nuk e ka për gjë që të gënjejë përsëri. Ishalla viti 2006 do të jetë ndryshe nga vitet e tjera. Ne për këtë votuam!

Edhe diçka tjetër, meqënëse është miratuar dhe ligji për sportet, të cilët mund dhe duhet të kalojnë në S.H.A., mendohuni mirë kujt do t'ia besoni sportin e qytetit. Mos



## Konkursi "Pegas 2005"

Gazeta "Lajmëtari i Beratit" njofton të gjithë krijuesit se vazhdon konkursi letrar vjetor "Pegas 2005", deri të hënën e fundit të muajit shkurt 2006, ditë ku do të shpallen fituesit.

*Konkursi do të zhvillohet:* a. për esse-në më të mirë. b. Për prozat poetike më të mira. c. Për ciklin me poezi më të mira.

Lajmëtari

Erinda Gjata,  
mësuese në Samaticë

### Flete ditari...

Bie muzgu, fllad i lehtë, del e bukura magjiplote Hene. Mbi majat e kreshtave rri e vështron, dëgjon dhe mendon: Vij atëherë kur dielli shkon të flejë e lë lamtumirën gjithë njerëzisë, e shkoj të nesërmen kur ai zgjohet. Ai u fal dritë e lëvizje mbarë njerëzisë, bën që vashave t'u skuqen mollëzat dhe prej trupit të djemve të rrëshqasin bulëza djerse, të përkëdhelin nuhatjen e vajzave.

Si gjithmonë, vështroj dhe më pëlqen të qëndroj nën dritën e hënës. Ajo qëndron zgjuar atëherë kur çdo gjë është prehur në gjumë e qetësi. Ndërsa unë qëndroj nën dritën e saj, kuvendoj me të, i them sekretet e zemrës sime. Por, ...një natë isha shumë e mërzhitur dhe mjaft e pikëlluar, gjithçka më dukej absurde se jeta në tokë më dukej pa dobi, pa interes.

- Ç'ke që më shikon?! Mos të dhimbsem vallë?! Ti që në çdo epokë ke përjetuar vrasje e prerje. Ngritje mbretërisht e rëniet e tyre. Lindje fëmijësh e vdekjesh. Ndarje e dashuri të reja. Sot më sheh dhe më dëgjon, por me gojë s'më flet. Sa gjëra të kam treguar e jam ngashëryer, por ti prapë ke qëndruar lart dhe gjithmonë ndriçon. A nuk më thua vallë, nuk je lodhur së vigjëluari? Ke parë mjaft gjëra, por, vallë, a ke shpirt?

Por Hena ngadalë zbret poshtë dhe vajzës i flet:

- Përse, moj vajzë, qan e psherëtin? Përse syçkat i mbush me lot? Mos u tremb! Jam ajo që shikon kur muzgu mbulon shtëpitë e iki atëherë kur drita e diellit lind. Herë në formë drapëri e herë e plot dhe e bukur.

- Po si kështu?! ...


- Mos u frikëso! Edhe unë kam lindur njëherë e të gjithë qëndronim bashkë si me Diellin, ashtu edhe me bukurinë Natyrë, apo me vëllezërit e mi, Yjet. Jetonim të lumtur e të gëzuar, lodronom së bashku. Por ne duhej të rriteshim, ashtu si edhe ti, dhe në fund do ndaheshim. Natyra u bë e madhe, krijoi Detin, Liqenin, Oqeanin, gjithashtu Tokën me Barin, Lulet, Pemët, Kafshët, Shpendët dhe së fundi Njerëzit.

Ajo u bë më e bukur se unë e Dielli ra në dashuri me të, ndërsa unë rashë në dashuri me Diellin. Ndaj edhe sot vazhdoj ta ndjek se mos vallë një ditë do ta takoj e do t'i shpreh dashurinë.

Ai del nga shtëpia atëherë kur ju i thoni "Agim", sepse Natyra zgjohet dhe Dielli i qëndron gjithnjë mbi krye, ta shoh, t'i qëndroj pranë. Shkëlqen gjithnjë t'i rrezatoj fytyrën, flokët e artë, i buzëqesh sa herë që ajo vështron dhe e përshëndet. E ndjek kudo që shkon. Ajo e do Diellin, por jo më tepër se vëlla.

Dhe kështu ai largohet kur e shikon se ajo është e lodhur e do të shtrihet e të prehet. Atëherë unë nxitoj ta kap, por nuk mundem.

Por një natë, duke vështruar Natyrën tek flinte e qeshur dhe e lumtur, hedh sytë diku më larg, buzë një liqeni, shoh dy njerëz tek ndiqnin njëri-tjetrin. Pashë sesi vajza po vraponte të kapte djalin. U afrova, sepse ishte diçka që e bëja edhe unë. Doja të shikoja në do arrinte ta kapte. E



kuptova. Ajo donte ta kapte djalin pasi i kishte vjedhur puthjen.

Duke lozur, ajo arrin ta kapë, por ai e puth përsëri. Për çudi, ajo nuk zë të vrapojë, por rri e përqaful me djalin duke vështruar liqenin, qetësinë e natës. Më pas, djali drejtohet nga unë duke bërë një premtim:

- E shikon hënën tek ndriçon? Po të mos ishte ajo, ne nuk do të mund të shikonim dot njëri-tjetrin nëpër errësirë. Dhe pikërisht për atë hënë, unë të betohem sesa ajo do të ketë dritë, unë do të të dua. Nëse ndonjëherë drita e saj do të shuhet, atëherë edhe dashuria ime për ty do të shuhet. Hëna di ta ruaj sekretin, ndaj saj mos ki frikë.

Që atëherë mua nuk ma bën zemra të shuhem. Nuk dua t'ua shuaj dashurinë që kanë për njëri-tjetrin. Por nuk ka vetëm gjëra të bukura, ka edhe të këqia, shumë më të këqia.

Vëllai vret vëllanë, i pasuri të varfërin, fëmija prindin dhe e anasjelltë. Nuk duroja dot dhe thirra shoqen Re të fshihesha pas saj. Ndaj, sa herë që ti nuk më sheh, do të thotë se diçka e keqe po ndodh dhe se unë nuk dua ta shoh.

- Po Yjet?!

- Ah, ata janë vëllezërit e mi.

Kur unë ndiqja Diellin, ata më ndiqnin mua duke m'u lutur të mos vazdoja se nuk kisha për ta kapur dot. Ishte i dashuruar me Natyrën dhe se kurrë s'do t'i kthente sytë prapa. Por nga dita e atij çifti dhe e atyre që pasuan, ne qëndruam në ndihmë të "Dashurisë". Kur djali dhe vajza u betuan për dashurinë e përietshme, një nga vëllezërit e

ë bie e do të ndalem në  
paj gjallë dashurinë.  
dëshirën kur unë të bie  
e...

dihmën e flladit të natës:  
rës, një yll po bie!" Ata  
panë, ylli po binte. Ata

jetë e përjetshme!  
lokush që sheh një yll që  
mrës dhe ajo ka për t'u

realizuar. Por ama ajo duhet të jetë e sinqertë, të burojë nga zemra. Ndaj, që atëherë ata nuk ndahen nga unë, sepse kanë një mision. Duhet të mbajnë gjallë ndjenjën tek ata që shpresa nuk vdes. Edhe unë qëndroj këtu dhe flas me ty, edhe unë kam një dëshirë. Pra, shpresën se një ditë unë do ta takoj Diellin. Duhet ta mësosh e të harrosh, sesa të jetojë dashuria do të ketë shpresë. Duhet të jesh e duruar dhe Ylli në zemrën tënde do të ndçojë. Mos i harro kurrë këto që të thashë. Shpejt ato mendime që ke, do të shkojnë dhe lotët nga sytë do të thahen, do të rrjedhin vetëm lot dashurie. Shpejt dhe ti do të thurësh këngë, vargje të tëra për mua, për natën, për yje fatsjellës.

Mos harro: jeto, dashuro, shpres!

- Mos ik, Hënë, kam për të të thënë...

- Oh, jo qenka veç një ëndërr.

### Dhimbja e jetës

Sëmundja është dhimbja e shpirtit,  
Është plaga që përtërihet në trup,  
Është gjurma që ngelet në jetë,  
Është dhimbja që klith çdo natë,  
Zemra që dënesë, me vaj e dëshpërim.  
Sëmundja është jeta e individit,  
Janë orët e kaluara në shtrat,  
Janë minutat e rënkimit nën zë,  
Janë sekondat e ankthit në gjumë,  
Shërbimi i durimit të kujdesit pa fund.

\_\_\_\_\_ vijon në faqen 9

vijon nga faqja 8

ESE

# ZANAT, ORËT SI FIGURË E GRUAS

Popujt gjatë gjithë rrugës së zhvillimit të tyre kanë krijuar thesare të paçmuara materiale e shpirtërore. Në fushën e artit e të poezisë hapat e parë i nisën në përfytyrimin në mënyrë fantastike të botës reale objektore të përpunuar artistikisht në formë të pavetëdijshme në ndërjegjen e tyre.

Njeriu, me botën e tij shpirtërore, me shqetësimet dhe ëndrrat e tij për një jetë më të mirë, krenar dhe i paepur, qëndron në qendër të mitologjisë, herë me një pamje fluide dhe herë konkrete, ashtu siç është vetë legjenda, por pas së cilës fshihet gjithnjë një e vërtetë jetësore. Mitologjia është një legjendë madhështore e pashkruar, e përcjell gojë më gojë si një mesazh, që vjen e na çukit edhe sot me kureshtjen dhe habinë se si në një stad aq primitiv të zhvillimit, shpreh vullnetin dhe ëndrrën për ta sunduar e transformuar natyrën.

Prodhimi letrar i një populli nuk mund të kuptohet pa njohjen e historisë së tij, ku historia shpesh është rezultati i të dhënave gjeografike, ndikimi i formimit tokësor dhe i natyrës së vendit mbi jetën dhe veprimet e banorëve. Trajatat e moçme në mënyrën e jetesës dhe në kulturën materiale e shpirtërore nuk janë ruajtur aq besnikërisht sa ndër shqiptarët. Sepse popujt e tjerë u civilizuan shpejt dhe i lanë doket e lashta. Dy janë faktorët sipas E.Cabej, karakteri i vendit dhe temaciteti i banorëve, kanë kontribuar në ruajtjen e vjetërsive. Karakterin konservativ të kësaj zone malësore të anës na e dëshmojnë disa aspekte e figura të besimit popullor. Këto në Shqipërinë e Veriut vazhdojnë të rrojnë si besim, në Jug tashmë vetëm në formë profane. Vajzat e malit (Orët) dhe ndihmësja në luftë Zana, janë figura të mitologjike edhe ja si i përkufizojnë ato: {Zana, figura e besimeve popullore shqiptare që përfytyrohej si një vashë me bukuri të rrallë (në Jug të Shqipërisë quhej Zëra), për disa mitografe ishte muza e maleve shqiptare, që banonte në gropat e Alpeve shqipe të veriut. Secili mal kishte zanën e vet. Ajo ishte një qenie hyjnore plot trimëri e egërsi. Nderi më i madh për një hero ishte të quhej trim si Zana ose të kishte një armë që siç thuhej, vret si Zana. Zanat këndonin natën nëpër burime, kërcenin dhe luanin, mblidhnin lule dhe laheshin lakuriq. Po Zana dhe ndëshkonte, duke shituar çdo njeri që guxonte t'i hidhte vështrimin kur ajo lahej. Prandaj, sipas besimeve popullore, shtegtari para se të kalonte në ato vende, kollitej që t'i jepte kohë Zanës që lahej, të largohej. Ajo i donte trimat shqiptarë dhe i ndihmonte ata, sikurse Atena, Palada e Homerit, ndihmonte dashamirësit e saj: Diomedin dhe Odiseun. Zana frymëzonte edhe këngëtarin e maleve, sikurse muza greke poetin lirik për këngët popullore të kënduara me lahutë. Disa mitografe ja të mendimit se emri Zana buron në latinishtja Diana. Kulti i fortë i Zanës Shqipëri në kohën antike na bën mendojmë se te zana kemi të bëjmë

një hyjni vendase para greke. Zane: vajzë e bukur.

Ora, figurë e mitologjisë shqiptare, që përfytyrohej herë si grua, herë si gjarpër. Besohej se jetonte në pyje, në fusha, troje ose pranë njerëzve. Ishte bamirëse, sepse ndiçonte mendjen e njerëzve dhe u mësonte atyre artin për të shëruar sëmundjet. Ajo ndihmonte dhe u sillte fat të mirëve, ruante njeriun, shtëpinë, fisin. Kjo duket në shprehjet e popullit: "Ora e njeriut", "shkoftë Ora e dëgjoftë". Por, megjithatë atë e paraqitnin edhe si të keqe. Besohej se ai që ndeshej me, vritej ose sëmurëj. Kjo duket në mallkimet që bën populli: "Të shiftoftë (të preftë) Ora", "Të martë Ora e ligë".

Në rapsoditë është e gjallë bota mitologjike: zanat dhe orët janë qenie antropomorfe të ngjashme me gjysmëhyjnitë e botës klasike. Legjenda dhe përralla poetike nuk arsyetojnë mbi natyrën e tyre, por na i paraqesin vepruese. Janë të dukshme, sepse kane trupa të shumë të bukur, por mund të bëhen edhe të padukshme, kur e lyp puna. Fuqia e tyre është mbinjerëzore. Por një kreshnik me forcë të jashtzakonshme mund t'i plagosë dhe mund t'i çenjë. Orët dhe Zanat kanë intuitë të veçantë lidhur me të ardhmen e bujarëve apo të agallarëve, dinë fatin, rrezikun dhe fundin e tyre. U vijonë në ndihmë sa herë që gjenden ngushtë. I shërbejnë dhe i mjekojnë me barna, kur plagosen për vdekje. Në to përmbaht koncepti primitive i natyrës. Zanat të shitojnë, po kalove mbi tryezën e tyre. Zanat për natyrën e tyre konsiderohen si qenie bamirësie. Marrin nën mbrojtje kreshnikët. Nuk hakmerren, nuk bëjnë keq. Ka një ndryshim, pra, në mes të Orëve dhe Zanave. Orët vdesin me vdekjen e atyre që ato mbrojnë. Orët mund të kenë edhe formë kafshësh, kurse zanat përkundrazi duken gjithmonë si qenie femërore, madje edhe me funksion amësie. Zanat e ciklit të kreshnikëve në rapsoditë e arbëreshëve njihem me fenomenin fonetik të rotacizmit "Zara-Zit". Derada i jep italisht "Donne sopra nnatyrall", ndërsa Dorsa i përktheu italisht "Fate".

Ja një shembull nga folklori arbëresh:

"Ish një shesh menjë arrë  
atje bridhnin zarazi ...  
ndodhi e vate nd'at'koc  
vasha e pa -dimë  
zarazit e rodhtin  
e rodhtin e mbajtin."

Në rapsodinë "Halili merr gjakun e Mujit", p.sh., jepet ky përshkrim i orës: "Gja e vogël ora qi po ishte, si dy rrefen'at ball dy dy mi kishte, dy herë rresht plaku s'mund e ka kqyrë."

Kurse në përrallën "E Bukura e Dheut dhe shtriga", thuhet: "Ish ora, -tha, -njikaqi gja e vogël, pas si rrezja e diellit... e s'u ndej njeri me e pa, se t'i e byrte syte".

Populli ynë ndër shekuj ka qenë autoritar. I ashpër dhe gjithmonë ekzistonte rendi patriakal, ku pushteti ishte i burrit. Koka ishte burri; ai gjykon, ai vendos, duhej bërë çka thoshte ai. Po si ka mundësi që në një vend patriakal, forcat e mbinatyrshme (Zanat, Orët) të ishin femra e jo meshkuj?! Por nuk i thonë kot një shprehje: "Koka është vërtet burri, por gruaja është qafa, është ajo që lëviz kokën!" Kjo do të thotë që vërtet gruaja (femra) është e brishtë dhe e përlulur, por edhe ajo ka prestigjin, vendin e saj në shoqëri edhe në atë kohë. Ajo nuk është vetëm femër, ajo është edhe bashkëshorte (grua) edhe nënë. Pra, si e tillë ajo kujdeset jo vetëm për shtëpinë, por edhe për burrin, për fëmijën. Asaj nuk i vjen hiç mirë kur dikush nga këta nuk ndjehet mirë, sikurse zanat dhe orët. Femrat shqiptare ashtu si dy figurat mitologjike janë të brishta, bamirëse, por edhe të egra e hakmarrëse nëse kërkon t'i çenosh. Eposi ynë na jep plot shembuj të tjerë; nëse kërkonin të përdhosnin identitetin e saj, krenarinë, ndershmërinë, ajo e kishte më mirë të vriste veten (të mbytej, të hidhej nga shkëmbi), sesa të ndodhte kjo gjë. Ose jepnin kushtimin për dylyftim ashtu si Zanat për luftë. Ose në rastin e fundit kur nuk kishin asnjë krah mbrojtës, ato bëheshin si djem dhe luftonin vetë kundër krajlave, bajlozëve dhe i mundnin sikurse Zanat dhe Orët. Por edhe nga bukuria ato shfaqeshin njësoj, të bukura, hyjnore. Ndeshim shpesh epitetet, e bardhë, e hollë, vasha e bardhë, Zana e bardhë, letër e bardhë, letër e hollë, mëz me këmbë të holla si të kaprollit. Në përshkrimin e bukurisë së Tanushës këngëtarin popullor i ka marrë elementet krahasuese nga natyra që e rrethon:

**"Vetulla e saj e drejtë si fiskaja,  
shtegu i balli si shtegu i malit  
kur merr hana me prarue,  
dhambët e bardhë si gurzit e lumit,  
fill mas shiut po i shndrite dielli, etj.**

(Banorëve të Gadishullit Ballkanik u pëlqen të shprehin me krahasime vlerat fizike të gruas. Shtrati i gruas krahasohet me një selvi, me një purtekë të artë, me një fill ari, edhe me një kall. Fytyra e vashës me diellin ose me yjet e mëngjesit. Leshërat me fije ari, ballet me hënën, vetullat me gajtanin, sytë me ullirin ose me rrushin, faqet me mollën, buzët me koralet, qafa e gusha me farfuri ose me mana, gjiri me limon, mesi me unazë, duart me qirinj (E. Çabej, "Shqipëtarët midis lindjes dhe perëndimit").

Këngë dasme:

**Nusja jonë arbërore, arbërore,  
E bardha si qumështire, arbërore,  
E kuqe si koqe, arbërore, etj. etj.  
Sa e bukur është nusja, marshalla,  
marshalla,  
Balli i saj si perishan,  
vetullat por si gajtan,  
syri si fixhan, mashalla, mashalla.  
E ka hundën si qiri  
e ka qafën si kuti,  
dhëmbët si inxhi,  
qafa si zambak,  
shtati ai selvi,  
ashtu është, ashtu është.**

Vete karakteri i pozitës gjeografike malësore, një klimë e ftohtë, e ashpër, i bën që edhe shqipëtarët të jenë një natyrë e ashpër, kërkuese sepse përveç

vetvetes nuk kishte se kush t'i ndihmonte. Popull që gjithmonë ka qenë pikësynimi i pushtimeve dhe i mohimit të së vetmes, jetës, lirisë. Po a jeton shqiptarja pa fluturuar, pa dihatur në qiellin e lirisë, në shtëpinë e saj? A mund të vritet ajo? Ajo krijesë shekullore? Ku jehona e zërit të saj oshëtin nëpër shekuj, në cdo epokë dhe kushdo që ka vesh e dëgjon. Ajo dëgjohej akoma kur duan t'ia ngushtojnë atë qiell ku ajo fluturon dhe ruan çerdhen e saj. Kalojnë vite, epoka së bashku me eposin e kreshnikëve se bashku me to (Orët, Zanat). I shin ato që i ndihmonin trimat tanë kreshnikë, ishin pikërisht ato që e ndihmoni poetin, i jepnin frymëzim për të shkruar. Ndërhyrja në çaste të vështira e vendimtare e këtyre qenieve mitologjike, zakonisht, shërben vetëm si një mjet artistik i kohës, motivet e veprimeve të heroit, lëkundjet shpirtërore, mendimet e përjetimet e tij, dhe, në një plan më të përgjithshëm, karakterin e ligjshëm e të kushtëzuar të veprimeve të tyre, ndikimin e rrethanave e të mjedisit shoqëror në kryerjen e këtyre veprimeve.

Tek GJ. Fishta në "Lahuta e Malësisë". Pra, frymëzimi i muzës së poetit. Poeti bashkëbisedon me zanat, lutet t'i japin frymëzim e forcën për të kënduar episode të ndryshme të këngës së lahutës. Ai herë i quan Zana, herë Hije. Nuk heziton gjithashtu që me intuitën e vet artistike t'i quaj Shtozovalle. Pikërisht Gj. Fishta është ai që dëgjoji zërin e shqiponjës dhe shkruajti një tjetër epos, në kohë më të vonshme, por me të njëjtën ngjarje. Historia përsëritet! Shohim se si tek kënga "Zana e Vizitorit", ato merrziten nga fatkeqësitë që i ndodhin një populli:

"Zana e madhe kundron betejën e përgjakshme nga më e larta pikë e malit vizitor mblbi Plavë, ashtu si Zeusi sodiste luftën e Trojës nga maja e lartë e malit I da. E zemëruar në kullm kur sheh Tringën e virtytshme, e cila që fëmijë kishte qenë nën mbrojtjen e zanave të malit, ajo zbret për t'i marr trupin e për ta sjell në rudinat e malit Vizitor. Trupin e saj e lajnë me ceremoni, e ndërrojnë dhe e varrosin rrëzë një bliri, ndërsa Zana e Madhe e vajton. I duhej marrë haku. Ky është vullneti i Zanës së Madhe që ngrihet mbi malësinë dhe u lëshon burrave kushtimin për të shpejtuar për në fushën e betejës e Nik Shiqit. Retë e luftës mblidhen në horizont ndërsa fiset përgatiten për në betejë."

Miti përsëritet, zanat, orët?! Përsëri aty, të ndihmojnë trimat, pikërisht ata që e duan me të vërtetë lirinë, kulturën, kombin, fisin e tyre. "Historia përsëritet!"

Këtë herë në një epokë tjetër, me gjenerata të reja, por me të njëjtin epos. (Ismail Kadare "Krushqit janë të ngrirë".)

... Megjithëse i zyrtë e i përgjakshëm, eposi i vjetër i kreshnikëve, si rallë ndonjë tjetër, zbardhëllente nga vellojt e nuseve, dasmat dhe krushqitë midis shqiptarëve e sllavëve. Veçse ato ishin gjithmonë si në ankth: dasmorët nuk shkuan kurrë tek shtëpia e nuses. Orët, Erenitë shqiptare apo sllave, i ngrinin krushqit gjatë udhës. Eposi i vjetër mund të kishte fare mirë nëntitull "Krushqi të pamundura" ose "Krushqi të ngrirë"... (Këtu Zana është veshur me petkat e një gruaje, Teuta Shkreli, e cila kujdeset për të plagosurit, t'i kurojë ata, qan për fatkeqësinë e tyre, por i frymëzon ata të luftojnë kundër krajlëve, bajlozëve të zinj.)

# ZILIA NJEREZORE, ARMIKU ME I MADH I QYTETERIMIT!

Nga Alban Guri

Te gjithë pa perjashtim, flas për ne shqiptaret, sot shtrojmë problemin e ecjes përpara si shoqëri duke thënë shpesh "Po si drejtin po shkon kjo punë kështu? Nuk merret vesh asgjë! Njerezit janë kthyer në kafshë!"... etj., etj., etj., si keto. Argumentin mbi kafshën-"njeri" që ka si ambicje njeriun dhe mundohet t'i ngjajë atij, u mundova ta paraqes të detajuar para disa ditësh në një të perditshme. Por problemi ngre koke dhe në luftojmë me keto shprehje e ide sa here që na preken interesa personale, sa here që degjojmë ose vërejmë fenomene që na demtojnë në ose të njohurit tane. Behemi kështu pjesë e padiskutueshme e observatorit shoqëror, i cili në mënyrë të pakundershtueshme konstaton se jo vetëm që qyteterimi nuk po ben me ecje përpara, por ai po peshon kthimin mbrapa, kokeposhte, me renie të lire, sic vertetohet me se miri në ligjet themelore të fizikës kur kurba e energjisë mberrin pikën e saj kulmore dhe me pas kthehet në nivelin prej nga u nis.


Me këte shqetesim ballafaqohemi në shqiptaret e prapambetur por edhe mbare bota e zhvilluar e njerezve. Ka padiskutim një kthim mbrapa në vlera, marrëdhënie njerezore dhe konceptim mbi të ardhmen sot tek pjesa dermuese e individëve. Qeniet që nga njëherë vetequhen njerez, nganjehere sforcohen të sillen si të tilla, nuk kanë me sy të kthjellët për të parë botën, shtepinë e tyre. Ata tashme e shohin çdo gjë nepermjet ekranit të televizorit, reklamave publicitare dhe syzeve të diellit që janë bere kusht i domosdoshem për status qytetarie. Ata nuk kanë me memorie, kanë harruar nga dhe si erdhen deri këtu në vitin 2006 pas Krishtit, në epokën e mirëqenies, të komoditetit, të teknologjisë së përparuar. Ata nuk vleresojnë me objektivisht dobishmerinë e antibiotikeve, të energjisë elektrike, të telefonisë, të motorit me djegie të brendshme dhe të mikroprocesoreve. Individet sot e shohin të gjithë këte arritje si një vitrine mallrash për t'u blere dhe për t'u patur brenda sferës private të kontrollit të gjithsekujt. Si një mall pra për t'u vene në dispozicion të kenaqesive dhe kapricëve të

secilit prej tyre që i pelqen t'i thote vetes njeri, por që ndoshta nuk është i tilla.

Jo të dashur individë, ose qenie me aspirata të larta njerezore. Si të doni po ju quaj. Nuk është kështu. Keto arritje të mrekullueshme që permenda janë fryt i perpjekjeve dhe i mundimeve, i lufrave dhe i sakrificave të njerezimit në mijera vjet. Njerezit janë perballur gjithnjë me kafshet e pyllit e të malit, janë perballur me gjite llojet e fatkeqesive natyrore. Kane luftuar edhe me menyren e grupimit në tufa që kanë si karakteristike kafshet me fytyrë njeriu që synojnë pushtetin dhe e kanë bere kete për të mbojtur vlerat e qyteterimit dhe meritokracinë. Janë perballur edhe me tradhtinë dhe xhelozitë brenda llojit të vet, pa ia kanë arritur ketij stadi që sot gezojnë dhe me naivitet, indiference e pa e kuptuar po e humbasin dalengadale.

Pra, jam duke vene theksin në fijen e holle konceptuale që ndan të mirën nga e keqja, zhvillimin nga regresi, harmoninë midis njerezve nga perçarja, dashamiresinë ndaj të ngjashmit ose urrejtjen e pashpjegueshme ndaj tij. Dhe kjo gjendje e turbullt, ky sensacion djallezor, ky abis i eret dhe i thelle në mendjet dhe në zemrat tona është zilia. Në shqiptaret kemi gojedhenat tona me vellezerit zilique kur njeri nuk dëshiron të kishte akoma dhe me shume, por lutej që të shihet të skamur vëllain e tij. Edhe grupimet e tjera shoqërore, etnike, kulturore, politike, kanë shembuj të tyre mbi këte argument, ku zilia merr supremaci ndaj dashamiresisë dhe bashkepunimit.

Në të gjithë po harrojme të dashur miq se njerezimi ka notuar në gjak me mijera vjet për të siguruar zjarr për t'u ngrohur, veglat e punes, pak drithe, pak buke, me pas rrotën për të levizur, disa kështjella, me vone disa qytete. E me vone akoma shkollat, barnat, spitalet. Për të mberritur në shekullin e XX ku vetëm në gjysmën e dytë të tij, zhvillimi pati një hov kaq të madh, sa mund të themi se vetëm në 50 vjetet e fundit njeriu u realizuan pjesa me e madhe e aspiratave të tij. Ai mberriti deri aty sa të fluturojë. Perballja me të keqen, me sfidat dhe me paditurinë i shkaktoi humbje të medha njeriut në shekuj,



por gjithsesi ai triumfoi. Sot ka mbetur në vend. Realisht po kthehet mbrapa për gjithë motivet dhe shembujt që njohim, që thame me lart dhe që do rendisim me poshte.

Mbas arritjes të paimagjinueshme na ofrohet si garanci për t'i ruajtur ato: ndergjegjia, harmonia, bashkejtesa, por në jemi të mposhtur nga zilia, nga ky armik tinzar, i padukshëm dhe fatal për njerezit. Ky element destruktiv ka therrmuar ide, individë, vellezer, bashkeshorte, familje, popuj, kombe, kontinente. Ai na pershkon në momentin me të papritur. Në pjesën me të madhe të rasteve ai vjen kur jemi të kamur ose të pozicionuar dhe nuk ballafaqohemi me me luftën për mbijetesë. Zilia lind pikerisht aty ku koha shpenzohet jo me me punë dhe prodhimin e dickaje, ku edhe lodhesh e s'ke kohe për të kultivuar ziline, por duke ndenjur me të tjeret, duke biseduar me ta dhe duke hyre kështu gabimisht e verberisht në një kompeticion negativ me ta. Ketu, në këte kontekst na lind pyetja "Po ky more, me i mire se mua i duket vetja?! E c" është ky?! Kush ishte ky?! Cfare ka bere ky që sot e shoh ketu?!" Nuk duhet ta ngaterrojme me gjykim objektiv që lind kur shohim me shume para një bandit dhe me një post të rendesishëm një të paafte. Në rastin e zilise syte na ertesohen, mendja na ngushtohet, ndergjegjia asfiksohet dhe iu hapet rruga instinkteve.

Nuk kemi bere asgjë tjetër pervecse jemi kthyer tek kafsha. Tani na mbetet vetëm të parashikojmë se me c'ashpersi do ta luftojmë tjetrin, atë që na shkaktoi ziline. Të parashikojmë se çfare tragjedie do të na hartojë dhe serviri prapa shpine, vëllai,

kusheriri, komshiu, shoku, kolegu, miku, dashnori, bashkeshorti.

Dhe natyrisht ketu nuk ka dhe nuk mbetet aspak vend për t'iu gezuat arritjeve dhe mirqenies olektive të paguar me gjak, sakrifica dhe mundime mijeravjecare. Jo, nuk do të mund të vleresojmë arritjet tona: makinat, celularet, shtepite, karten e kreditit, pushimet, gostitë, shkencën që perparon në luftën ndaj semundjeve. Nuk do të mund t'i gezohemi faktit se mund të jetojmë mire me prinderit, me miqtë, se mund të dashurohemi, të martohemi, të behemi prinder, të leme në këte bote shenjen tone njerezore, vepren, punen tone.

Jo, në do të kenaqim në rastin e zilise instinktin tone primitiv, të paarsyeshëm dhe kafshëror. Do ndihemi të kenaqur që pas zilise se provuar ndaj dikujt ose dickaje, atë dikushin ose dickanë ta kemi shkatërruar. Desha të them se do lehtësohemi vetëm kur ta kemi eliminuar shkahun e zilise tone. Atehere në do të ndihemi rehat dhe do të harrojme se kemi vendosur me një veprim kryenec, kafshëror, aspak modern, aspak të qytetëruar, të kthehemi mbrapa, në kohën kur njerezimi filloi të zhvillohej.

Ky pra është armiku me i madh i qyteterimit që të gjithë ne predikojmë, që të gjithë e duam, që të gjithë ne ia vjellim të mirat deri në abuzim. Ky armik i padukshëm, që në të gjithë e justifikojmë, e fshehim me fanatizëm në tunelet e erreta të mendjes tone, është një fenomen që nuk denohet ligjerisht. Zilia nuk parashikohet nga kode penale, civile apo administrative, nuk gjykohet negativisht në kulturen e perditshme. Ajo ka privilegjin të anashkalohet kur dikush e ve re tek dikush tjetër, bile të mos themi se i mbyllet goja atij që e ve re tek dikush tjetër si burim ngaterresash në komunikuesh.

70-të "The Hills Have Eyes". Aty behet fjala për një të përkopat që në një familje në shkretëtirë.

Kompania gjigande Disney riprodhon një tjetër film me aksion me titull "The Shaggy Dog." Filmi del në kinema më 10 maj dhe ka për aktorë kryesorë Tim Allen dhe Kristen Dunst.

Tjetër film i mirëpritur për femijet është edhe filmi me animacione mjaft fitimprurës i vitit 2002 "Ice Age" i cili rikthen zërat e komedianit Ray Romano kur të dalë në kinema më 31 mars.

Seriali i tretë i Tom Cruise, "Mission Impossible", me regjisor J. J. Abraham sjell në kinema në muajin mars edhe aktorët Ving Rhamer, Keri Russell dhe Simon Peg.

Filmi "Poseidon", nuk është zyrtarisht ribërje e filmit klasik të vitit 1972, por i ngjason shumë për nga përmbajtja, pasi i referohet novelës së Paul Gallico. Pesonazhet edhe në këtë film ndodhen të bllokuar në një vapor të përmbytur. Regjisor

Një pjesë e mirë e asaj që Hollivudi do të servirë këtë vit duket se është mjaft e njohur. Filmat më fitimprurës, ata që pritet të mbajnë rekorde gjatë stinës së verës...ose do të jenë versione të reja të filmave që kemi parë ose vazhdim i tyre.

Thuajse stina e verës do të dominohet nga tre filma të mëdhenj. Këtu futet filmi "X-Men-3", për të cilin ka filluar punën për shkrimin dhe montimin e tij. Filmi do të ketë karaktere të reja si Kelsey Grammer dhe John Agdashlo, kështu që do të jetë një pjesë e tretë e filmit do të jetë i ri në mesin e mëparshëm. Filmi pritet të jetë i kinematë amerikane në muajin mars.

Është edhe "Superman Returns" që do të jetë ndër më të kushtueshmet t'u xhiruar. Filmi duket se do të jetë versionit të vitit 1977. Për të parën herë, duket se nuk ka farë shance që mundë të mos u përkthet në versionin e këtij filmi.

## Disa nga planet e Hollivudit për vitin

### 2006

Regjisorin Bryan Singer që njihet me dy serialet e filmi X-men ka marrë për sipër xhirimet e "Superman". Rolin e Lex Luther e luan Kevin Spacey dhe Brandon Routh në rolin e Klark Kent ose Supermenit. Filmi del në kinema në muajin qershor.

Filmi "Piratët e Karaibeve" që korri suksese verën e vitit 2003, vazhdon me pjesën e dytë me titull Pirates of Caribbean: Dead Man's Chest. Filmi që del në kinema në muajin korrik ka rikthyer në skenë aktorët Johny Deep, Keira Knightly, Orlando Bloom dhe Jack Davenport.

Këta janë tre filmat kryesorë të stinës së verës dhe është shumë e vështirë të thuhet se cili do të jetë mjaft i suksesshëm dhe cili mundë të jetë zhgënjim për

shikuesit. Por çfarë tjetër mundë të presim për vitin 2006? "Underwood Evolution": Aktorja Kate Beckinsale vazhdon luftën kundër krimin, të vazhduar në pjesën e parë të filmit të vitit 2003. Kësaj here ajo lufton kundër njerëzve-ujqër, dhe vampirëve. Pjesa e dytë e filmit "Big Moma" me aktor kryesor komedianin Martin Lawrence, i cili luan rolin e një agjenti policie të maskuar si një grua zezake, del në kinema këtë muaj.

"Final Destination 3"...pjesa e tretë e filmit sillt rreth ngjarje të një maturanti që pëson një aksident fatal në një park lojrash. Filmi del në kinema në muajin shkurt. Një tjetër film që pritet të ketë sukses është edhe ribërja e filmit të viteve

Foto:

**"MANGALEMI"**

Vëllezërit Nasi & Mika

**KAFE "MIAMI"**

"Çelepias" pranë 6 katëshit...

Tel. 069

2151722

Shitet një shtëpi dykatëshe në lagjen  
"Muzakaj" e përbërë:

2 hyrje, 7 dhoma, 2 mjedise gatimi, 3 banjo,  
ballkon, verandë, oborr, parking,  
kopësht me pemë.

Tel: 032 32 638

**"ALUSH QERESHNIKU"**

Në dyqanin tonë do të gjeni:  
80 lloje verërash. Të gjitha  
verërat e Beratit.

PAISJE HIDROSANITARE

**Dyqani i Shpatës**

Adresa: AXHENSIA

TEL: 068 27 03 384 (ILIA)

Artikuj shkollorë zyre  
fotokopje, shtypshkrime, plastifikuese,  
punë kompjuteri.  
**INTERSIG.**

Adresa: Ngjitur me postën qendrore

FERDINAND KADIFEJA

Tel: 32 246

**Shumica**

**Ushqimore**

**Tek Axhensia**

**Rexhep Arza**

**Okazion**

Shiten makina qepse për lëkurë dhe  
këpucë, shitet lëkurë dhe copa lëkure.


Shiten paisje të ndryshme.

: 069 22 082 72

**Steku** 

**Ndërtime**

: 069 20 96 191



Syri i  
Lajmëtarit

# Pesë motrat

## Refat Libardhaja mësuese

... të jesh berati me gurin në dorë të gjitha, njëren patjetër. Kjo vjen sepse ato vetëm kanë një emër, por edhe kanë krijuar një emër me punën e tyre shumëvjeçare që s'mund të harrohet kurrë.

Në gjithë historinë e tij Berati nuk mund të ketë patur një rast të tillë, ku brenda një familje të pesë motrat të jenë mësuese. Janë motrat Sollaku. Pesë mësuese të rralla, pesë mjeshtre të pakrahasueshme, pesë pedagoge, pesë duararta, pesë mendje të ndritura, pesë demokrate.

Jo vetëm personalitete në fushën e arsimit, por dhe individualitete me një reputacion të padiskutueshëm në shoqëri e gjetkë. Modestinë e tyre të lartë e kanë kthyer në virtyt.

Prandaj i gjithë qyteti i do, i respekton dhe kurrë s'ka për t'i harruar, sepse me jetën dhe punën e tyre, ato janë pjesë e biografisë të këtij qyteti.

Gjithë familja e tyre është një ansambël kulturor, se mbartin në vetvete vlera të mëdha njerëzore.

Shtetarët e të gjitha kohërave, duke injoruar veten e tyre, asnjëherë s'kanë ditur t'i çmojnë këto vlera dhe t'u japin atyreve zonjave vendin që u takon në shoqëri. Ata s'kanë ditur të çmojnë më të mirat, më të ndershmet, më të rrallat, më demokratet që ka ky qytet!

Po, punë e madhe, i ka çmuar populli më mirë se kushdo tjetër.

Ato janë të vetëdijshme për vlerat e tyre, prandaj dinë që të çmojnë edhe të tjerët.

Bima nën pemë do të bjerë, thotë populli.

Ato janë bijat e devotshme të të nderuarit Sinan Sollaku. Një prind i shkëlqyer dhe një burrë i rrallë për nga karakteri dhe shpirtgjersia e tij. Arkitekt, projektues dhe një ndërtues i zoti që për vite me radhë e zbukuroi qytetin tonë me godinat sa të bukura, aq dhe me cilësi të lartë që u kanë rezistuar të gjitha kohërave dhe rrebesheve që ka hequr ky qytet. Gëzonte një reputacion të padiskutueshëm jo vetëm në Berat, por edhe shumë më gjerë. Veprat që ka nxjerrë ai njeri kurrë s'kanë qenë të diskutueshme.

Komunizmi i punoi të zezat e ullirit. I mori tërë pasurinë që kishin, aq sa edhe unazat ua hoqën nga gishtat grave. E burgosi në burgjet më famëkeqe që kishte. Mjerë ai se çfarë hoqi në to. Nuk u dorëzua kurrë.

Njeriu që nuk dorëzohet, është më i fortë se fati...

Kishte një përkushtim të rrallë për familjen. Së bashku me gruan e tij Neslien sakrifikuan çdo gjë vetëm për arsimimin e vajzave të tyre nëpër shkollat më prestigjioze të vendit. Instituti Nëna Mbretëreshë e gjetkë.

Vajzat e Sinan Sollakut në çdo kohë kanë qenë shembull karakteri dhe virtyti të përkushtuara për punën që bënin, prandaj gjatë gjithë jetës së tyre ato i kanë pasur të shkëlqyera rezultatet. Kudo që kanë qenë nëpër fshatrat më të largët e më të vështirë, ato me të njëjtën përkushtim kanë nxjerrë breza e breza të tërë nxënësish të shkëlqyer, duke i dhënë atdheut ndofta inxhinierë, doktorë, shkrimtarë, arkitektë e pse jo edhe deputetë.

Pesë motrat mësuese dhe mbi to me përkujdesjet e një nëne, motra e madhe Bibua. Një grua e rrallë për nga mençuria dhe fisnikëria e saj.

Me gjithë peshën e viteve që mban në supe, ajo rrezaton vetëm mirësi e dashuri. Të dëgjosh fjalët e saja, do të habitesh me thellësinë dhe saktësinë e mendimit që shfaq. Ajo di të komunikojë me çdo moshë me atë ëmbëlsinë e zërit dhe të fjalëve të saja ajo bën për vete çdo njeri.

Tek ajo çdokush do të gjejë, nënën, motrën, shoqen dhe mikeshën më të mirë të jetës së tij. Është nder dhe privilegj të jesh afër saja.

Të gjitha motrat ngajjnë si dy pika uji për cilësitë e rralla që kanë e duke plotësuar njëra-tjetrën ato janë një ansambël i gjallë në shoqërinë njerëzore të qytetit tonë.

Dudija, një mësuese e shkëlqyer dhe një grua me një personalitet të spikatur. Tepër krenare me një seriozitet që të imponon respekt. Ka vuajtur shumë në jetë, por ajo kurrë s'u përul para asnjërit. Ajo femër asnjëherë nuk ra nga majat e përsosmërisë dhe asnjëherë s'e ka ndier veten të vetmuar, sepse ajo gjithmonë ka qenë nën shoqërinë e mendimeve fisnike.

Kemi Rishën, me një pamje aristokratike. Është me të vërtetë një shembull i gjall tek ne mallin dhe kuriozitetin për atë shembull të jetës që po bëhet çmos për ta zhdukur. E devotshme në punën e shkëlqyer ajo i tregoi se sa lart qëndron ajo në jetë. Ajo gjithmonë ka pasur respekt dhe e ka mbajtur nën kontroll. Demokrate e orëve të para!

Shtëpia e Bardhë, ish-banka e vjetër, e ndërtuar nga Sinan Sollaku

Kush ka njohur Hatixhe Sollakun nuk mund ta harrojë lehtë zgjuarësinë e rrallë që ka dhe dijet pa kufijë që zotëron. E pa krahasueshme si pedagoge, ka një intuitë të rrallë për të njohur të tjerët dhe për t'i çmuar ata. Tepër zemërgjerë. Arsimit i kushtoi jetën e saj. Tepër krenare që ka edukuar breza të tërë njerëzish. Gëzon një autoritet të padiskutueshëm në shoqëri dhe në gjithë qytetin. Shembull i përsosmërisë së një femre.

Njëra nga vajzat e kësaj familjeje Sanija, mori rrugën e kurbetit së bashku me fëmijët e saja. Zoti i deshi prandaj u priu e mbara. Ata janë bërë "italiano vero".

Me pamjen e saja, me fisnikërinë, me karakterin dhe kulturën që zotëron ajo ka treguar, pavarësisht së keqes që i zuri si shumë të tjerë që kanë marrë rrugën e kurbetit, janë nga familjet më të mira që ka ky vend. Këto familje janë ambasadorët e paqes në vendin fqinj. Prandaj ne duhet ta falënderojmë atë dhe t'i urojmë zonjës Sanije Sollaku dhe djemve të saj jetë të gjatë dhe gëzime në jetë.

Buqetës së luleve të çupave Sollaku u mungon lulja më e bukur dhe më e freskët, për të cilën motrat më të mëdha krenohen me të.

Është Liljana ose siç e thërret Berati Lela. Është brilante nga karakteri dhe virtyti, specialiste në fushën e arsimit. E nderuar dhe respektuar nga kolegët, shokët e miqtë e gjithë qyteti. Zemërgjerësia e saj s'ka kufi. Gjithmonë gëzimi për të, ka qenë burimi që ka freskuar dhe ripërtërirë jetën e saj. E përkushtuar për demokracinë!

Familja Sollaku me gjashtë margaritarët e saj formon gjerdanin më të bukur të jetës familjare, një gjerdan i rrallë, i kushtueshëm që tregon vlera të pashtershme njerëzore që mban brenda vetes qyteti ynë.

E kaluara s'duhet harruar e as të vjetërohet...

Ne duhet të dimë se nga jemi nisur e ku duhet të mbërrijmë.

Te të gjithë është krijuar iluzioni se dikur do të ndryshojë gjithçka. Le të shpresojmë.

### Kudret Selamaj

## NETË STATUJASHTË KRISTALTA

Mjerimi, gurë në qafë,  
Ah mjaft, mjaft me skaf!  
Për ku shkoni keshtu?  
Ngopet me njerz barku blu?  
Goditur nga çomange e mjerimit,  
Bini në kallkan të qefinit.  
Një thirrje thikë në hapësirë.  
Ka njerz përtej, a shkretëtirë?!  
E zezë vdekja zbardh dhëmbët,  
T merri largon peshkaqenët.  
Herë zhytet herë del gomonia,  
E dalga gëlltit kufoma.  
Brenda uji i ftohtë u fut,  
Ishte dhe shtepi dhe tabut.  
T ë vdes ndër duar njeëriu yt,  
Mos qaj, se të vishen sytë!  
Mbahu me thonjë dhe me dhëmbë,  
Se ka dhe nga vdekja më rëndë.  
Por po nuk u gjete kurrë?  
Ku do të vendosen dy gurë?  
Me zjarr të zemrës ndiz terrin,  
Digje xhehnemin, vet ferrin.  
Jo, flokët s'mu bënë nga xheli,  
Krëhër liri dhe fiye telli.

O netë me thonjë të zezë,  
Shkurtohu, hajde mëngjes.  
Njëri -tjetrin qysh e mban,  
Këmbët në allçi kallkani.  
Dallge e shkumbe vjen verdallë,  
Brenda të vdekur e të gjallë.  
Nuk është kali i Kostandinit,  
Loz deti me skaf të emigrimit.  
Koha, kur rrugët, shkojnë tutje,  
Ka prindër ka dhëndërre nuse.  
Kur s'bëhet njeri i gjallë  
Hëna rrezet, zbret shkallë  
Permbi retë zuri të ngasë  
S hpie shpirtrat në parajsë  
Sa as kanë ardhur, e as ikur!  
Dhe deti është bërë më i kripur!  
Po ti, kuti haberi, celular?  
Ngriji tingut, mos i hiq zvarr!  
Me britma me duar në kokë,  
Bertasin! T okë! T okë!  
Viktimat po vijnë te vatra,  
O netë statujash të kristalta.  
S'është vocerraku që mbajti Migjeni,  
T hellë, sa thellë, e gërryen veremi.  
Rrugë skëterre, të zezë o det!  
Sa na kthyet?  
Po sa mbajtët për vete?...

**T**ë flasësh për “kontributin” e Pal Shkarpës në grupin artistik të këngës popullore qytetare “Berati”, do të duhet një kapitull i tërë. Por në këtë shkrim do të argumentoj e t’u përgjigjem disa pyetjeve me të drejtë shqetësuese të bëra nga një pjesë e qytetarisë beratase, për fatin e ecurisë së grupit artistik “Berati”: “Përse u shpërbë grupi popullor? Cila ka qenë arsyeja që u shpërbë? Pse e ndërpreu aktivitetin artistik grupi “Shyqyri Fuga”, e të tjera si këto.

Me të drejtë artdashësit beratas shqetësohen.

Ky grup popullor, siç dihet, u ngrit mbi bazën e ansamblit artistik popullor “Gorica” më 12.09.2003 pas 14 vjetësh. Me mjaft përpjekje e sakrificë u arrit që bashkia e qytetit Berat, ish-kryetari i saj z. Nikollaq Mata, i cili pasi e kishte ndjekur nga afër ecurinë e këtij grupi popullor, krijoi një “komision kulturor” për të parë nivelin, cilësinë si dhe vlerat e këtij grupi të këngës popullore e qytetare. Ky komision arriti në konkluzionin se ky grup ia vliente që të përfaqësonte qytetin e Beratit duke bërë në të ardhmen një punë me profesionistë, duke i propozuar këshillit bashkiak për miratimin e tij me emrin “Berati”.

Këshilli bashkiak e merr në shqyrtim dhe më 12.09.2003, me vendim nr. 55, i mbështetur në ligjin nr.8652, datë 31.07.2000 miraton grupin popullor të institucionalizuar me emrin “Grupi karakteristik i këngës popullore qytetare Berati”. Për qytetin kjo ishte një arritje e madhe në fushën e këngës popullore qytetare. I jemi mirënjohës ish-kryetarit të bashkisë Nikollaq Mata, stafit të këshillit bashkiak për vlerësimin dhe miratimin e këtij grupi popullor, i cili ishte ëndrra e gjithë pjesëtarëve të tij.

Në veçanti falënderoj mikun tim, ish-drejtorin e rinisë e sporteve në bashki, sot drejtor i qendrës kulturore z. Kadri Kuka, i cili më ka qëndruar pranë duke më mbështetur me të gjitha mënyrat që ky objektivi të realizohej. Është këmbëngulja e tij rreth një viti, që sot ne mbajmë emrin “Berati”, të qytetit të lindjes që i kemi dhënë dashurinë.

Ky grup popullor pa mbështetje e kishte vështirë të jetonte. Po kështu dhe bashkia në ato çaste e kishte vështirë.

Për ta mbajtur gjallë këtë grup të posakrijuar që të mos shkonte kot munda i shokëve, ajo dashuri e pasion që kishin për këngën, mendova dhe bisedova me Pal Shkarpën në Tiranë, djalin e këtij qyteti, i apasionuar për këngën popullore që të na ndihmonte për të na investuar, që ky grup të vazhdonte jetën artistike për të mirën e qytetit. Z. Pali pranoi, u tregua i gatshëm. Do të ishte i pranishëm ditën e martë më 10.06.2003 në Berat. Gjithashtu ishte i pranishëm dhe Emanuel Ndrio, krytar nderi i ansamblit “Gorica”. Pasi dëgjoi programin, iu bë qejfi. Në fillim investoi nga një këmbë e kravatë për secilin, më vonë na pruri nga një kostum. Grupi tashmë mori një fizionomi të plotë nga pamja e jashtme. Anëtarët e grupit popullor, nga dashuria, pasioni që kishin për këngën punonin tri ditë në javë, me disiplinë të rrallë artistike. Nuk i pengonte as shiu, as të ftohtit, as vera e nxehta e vitit 2003. Kur njerëzit bënin plazh, ne bënim prova si dhe merrim në analizë ecurinë artistike të grupit të këngës popullore “Berat”.

Kjo bënte që të shtohesh dashuria për njëri-tjetrin dhe mezi prisnim të takoheshim. Bisedat në takimet me njëri-tjetrin ishin rreth ecurisë së grupit tonë popullor.

Erdhi Pal Shkarpa “shpëtimtari” i këtij grupi, tha: “Peshku në Berat 300 gr

vete, ndërsa unë do ta rris do ta bëj killosh”. Kështu premtoi. Në fund pas shumë përpjekjesh të tij, arritjeve të bujshme e intervistave të shumta, të cilat nga ana e tij kishin objekt të caktuar, jo vetëm që s’e kaloi 300 gr, por mbeti cironkë. Sqarojmë më poshtë. Është e vërtetë ne pranuar të bashkëpunonim me Pal Shkarpën. Ne i besuam. Unë i dhashë gjithë besimin dhe dashurinë shoqërore se po shikoja te ky njeri që përpikëj për t’i bërë jehonë këtij grupi popullor. Jam i ndërgjegjshëm të them se sa herë që mblidheshim kur vinte, fjalët e mia i thurnin hymn, lavdi.

Fjalët e tij, fytyra e tij e ëmbël të bënin të besojë. Por në shpirt ishte tjetër njeri. Mendoja se ky njeri me të vërtetë i është përkushtuar këtij grupi e do të bëhen “mrekullira”, do të kishte perspektivën e vazhdimësisë. Por ndodhi ajo që s’besohej.

Duke marrë dhe mendimin e pjesëtarëve të grupit, i propozova z. Pali që të ishte “president” i grupit tonë popullor, më

5. Vajtja e grupit popullor në Napoli të Italisë, do të shoqërohet e do të filmohet nga “Top Channel” si dhe nga televizioni italian.

6. Nga fondi evropian mund të marrim një mijë euro.

7. Do t’i bëhet grupit pashaportë diplomatike, që do të lëvizë në shumë vende për të dhënë koncerte.

8. Pjesëtarëve të grupit do t’i lidhet një rrogë mujore.


(Nga takimi me Pal Shkarpën, datë 22.08.2003.)

Këto ishin një fluskë sapuni. Kur i dëgjoje nga goja e këtij “engjëlli” për momentin të bënin të fluturoje nga gëzimi. Ishte mjeshtëri.

Të gjitha ishin zhgënjime. Na mbante me ujë të ngrohtë. Merita e këtij Pali ishte

1. Organizimi i koncertit që u dha më 11.12.2003, ditën e enjte në Teatrin e Operës dhe të Baletit nga grupi karakteristik i këngës popullore qytetare

## Pasi realizoi qëllimet, Pal Shkarpa braktisi grupin e këngës qytetare



Stavri Bobo

26.06.2003. Ai e kundërshtoi në mënyrë të prerë duke thënë: “Larg e tutje. Ne si familje nuk pranojmë ofiqe. Na dënon perëndia. Por unë, -vazhdoi,- më bashkoi dashuria për qytetin. Unë do t’ju ndihmoj pa interes.

Kështu ky problem, për momentin u mbyll.

Në datën 3.09.2003, e mërkurë, në mëngjes takohem me z. Pali. Ai më thotë “Para ca kohësh më shtrove një mendim të shokëve që unë të jem “presidenti” juaj. “Po,- i përgjigjem. “Jam dakort”, më thotë.

Kjo më befaso i ishte kontraditore me atë që më tha më parë. Pasdite mblidhet kryesia e grupit popullor, ku merr pjesë dhe z. Pali Shkarpa. Kryesia, pasi e shqyrtoi, vendosi (shih bllokun nr.2 të procesverbaleve, dt.03.09.2003, e mërkurë, ku dhe ligjërisht e bëjnë president të këtij grupi popullor.

“Me mua, -thotë Pali, -do të jeni shumë mirë, por në fillim duhet të mbillni pastaj të korrni.

Dhe kështu u la. Mbill e mbill, po s’u korr asgjë.

Pal Shkarpa i premtoi shumë anëtarëve të këtij grupi popullor. Unë gjithmonë e vija në dilemë, e kujtoja, duke i thënë: “Mos premto, se nuk është mirë, nuk është serioze, nuk të besojnë se s’po bëhet gjë nga ato që ke premtuar”. Premtimet e z. Pali:

1. Kam porositur në Norvegji një mikrobus për të lëvizur grupi.

2. Kam blerë një foni në Itali, këto ditë vjen, nuk dimë se ku do ta vëmë. Fillimisht të marrim një objekt me qira.

3. Do të blejmë veglat muzikore.

4. Do japim së shpejti shfaqje në Napoli të Italisë, ku firma e mjekëve dhe e biznesmenëve të Napolit do t’i japë para të madhe grupit popullor.

“Berati”, ku angazhoi mjaft biznesmenë beratas me banim në Tiranë, të cilët dhanë kontributin e tyre modest për këtë koncert.

2. Çuarja e grupit popullor “Berati” në Prizren nga data 11-13. 06. 2004. 3. Koncertin e organizuar në Berat nga bashkia në data 28-29. 04.2004.

Të gjitha këto përpjekje nga ana e tij nuk ishin pa një qëllim të caktuar. Kanë një domethënie.

Kishim folur dhe kishim rënë dakort se grupi popullor “Berati” kishte nevojë për një rinovim. Vetë z. Pali kishte rënë dakort që të krijohesh një komision me specialistë në fushën e muzikës për t’i provuar anëtarët e grupit për vokalin. Kjo ishte normale. Më dt. 05.10.2004, para se grupi të fillonte provat, me një listë të diktuar nga Pal Shkarpa, komunikohen emrat e anëtarëve që do të qëndronin në grupin popullor. Ndërsa tetë veta, nuk u përmendën, por u tha që të largohen shokët që s’dëgjuan emrin. Kjo me të vërtetë i fyeu. Këta ishin: Xhoxhi Qako, Thoma Kajana, Llazar Kajana, Vangjel Bobo. Në këtë moment ndërhyj e them: “Këta i largojnë nga grupi, se kështu do Pal Shkarpa. Unë nuk kam nder të qëndroj, sepse nderin e kam me shokët. Nuk e lamë kështu me Palin, kjo është fyerje që i bëhet njerëve, të cilët nuk i mblodhi Pal Shkarpa, por i mblodhi dashuria që kanë për qytetin e lindjes dhe kanë punuar dy vjet rresht me një kontribut të pasqorë që se meritojnë të hidhen kështu”.

Në fund kërkova që të vinte Pal Shkarpa e të na sqaronte për këto veprime. Se i thonë fjalës “vjen një ditë Pal Shkarpa, ne e fusim nga dera, ai na nxjerr nga penxhereja”.

Mbledhja u realizua më datë 20.10.2004. Një pjesë shokësh u shprehën

me keqardhje për mënyrën se si i largoi nga grupi i këngës popullore. Për të gjitha këto, unë si përgjegjës dhe organizator i këtij grupi popullor, mbaj përgjegjësi të plotë para gjithë shokëve të mi të grupit se e mbështeta këtë njeri vetëm e vetëm për ecurinë e këtij grupi dhe s’kisha asnjë lloj interesi. Duhet ta kisha ndarë shapin nga sheqeri, si thotë populli, që në fillim, por se kisha njohur.

Ti, Pal Shkarpa, nuk bëre gjë tjetër veçse bëre që “buzëqeshjen na e ngrive në buzë”. Për një kohë të gjatë na ndave nga njëri-tjetri. Na godite gjithë kënaqësinë shpirtërore. Ti Beratit dhe këngën e tij nuk e do, pavarësisht që çirresh e çahesh dhe trumbeton në teori “për dashurinë” që ke për Beratit.


I vure emrin grupit popullor “Berati”, “Shyqyri Fuga”. Të gjitha i bëre për të realizuar interesat, tekat e tua dhe objektivat e tua. Ti ia arrite qëllimit me shumë mjeshtëri. E para, çdo gjë ia atribuove vetvetes qysh me largimin e anëtarëve të grupit dhe vënien e emrit grupit popullor “Shyqyri Fuga”, duke trumbetuar që “Pal Shkarpa ka meritë, si shpëtimtar dhe krijues i grupit artistik të këngës popullore “Shyqyri Fuga”. Ti vetëm sa i ndërrove emrin. Çfarë grupi ke ngritur? Kur dihet që merita u takon të gjithë shokëve që e ngritën këtë grup e jo ty.

Në datën 2.01.06, e hënë, ju z. Pali në “TV Elbasani” me anë të një dokumentari bërë nga ju, kushtuar vetes suaj, ngrije vlerat e tua si “krijues” i grupit “Shyqyri Fuga”. Kur kështu, z. Pali? E dyta, me porosinë tuaj, më datë 28.09.05, ora 17.00, bëre mbledhjen e këtij grupi duke thënë: “Unë nuk mund t’ju ndjek më”. Shokët, i kërkuan arsyen përse tërhiqesh. Arsyet te ky njeri janë të shumta, të cilat i përmenda dhe më lart. Ishte një pretext dhe si pretext përdori mospërmendjen e emrit të Pal Shkarpës në koncertin recital të këngëtarit Kujtim Babunja, i cili pati mbështetje nga bashkia e qytetit dhe nga qendra kulturore e qytetit, që e organizuan. Ky “njeri i perëndisë” me shumë cinizëm, kërkoi emër aty ku se meriton. Pse?

E treta. Pal Shkarpa e braktisi “Shyqyri Fugën”, ai nuk kishte nevojë për të. Kuptohet, ky emër i duhej për momentin. Anëtarët e grupit vazhdonin të “mbillnin” për Palin, por nuk i la të korrnin në mënyrë që të merrnin dhe këta një ditë fatet e mundit e djersës së tyre. Megjithë premtimet se do të jepte kasetën e koncertit të zhvilluar në TOB (Teatrin e Operas dhe baletit), kanë kaluar dy vjet, nuk e dha.

Po shokët nuk këndonin për Pal Shkarpën, por për qytetin e tyre, jetojnë me hallet dhe shqetësimet e tij për ditë. Ata e kuptuan më në fund kush ishte Pal Shkarpa. Kështu ne gjetëm veten dhe u bashkuam përsëri me njëri-tjetrin në grupin karakteristik të këngës popullore qytetare “Berati”. Me rastin e Krishtlindjeve, më 25.12.05, ora 18.30, ky grup u prezantua para publikut artdashës beratas me këngët e bukura popullore. Ai u duartroi për zemërsisht në sheshin qëndror të qytetit.

Ngrirja e buzëqeshjes, shkriu përfundimisht. Kemi, besim se kryetari i bashkisë z. Fadil Nasufi, i cili e ndjek me interes e në vazhdimësi artin e kulturën në qytetin tonë, së bashku me këshillin bashkiak do të marrin në konsideratë kërkesën e grupit popullor “Berati” për një financim simbolik. Nuk do të na zhgënjëjë si Pal Shkarpa. Vetëm kështu kënga



Agim Mehqemeja



E thërrisim shkurt Dete. Dhe kështu po e quaj, se e tillë qe jeta e tij, e shkurtër. Në këta kufij ruhet edhe e pashpjegueshmja që ajo mbart.

Ai ishte jetim dhe jetim la.

Ky nuk është një rast i padëgjuar dhe as i vetëm. Por ti, duke ecur nëpër shtigjet e kësaj jete, edhe pse pas shumë vitesh, kërkon të zbulosh ato që vetë jeta ia paratha, por që as ai dhe as ti nuk ia rrokët dot kuptimin për ta mënjanuar të keqen që i ndodhi.

E ëma i vdiq gjatë lindjes së tij. Në ato vite lindjet priteshin në shtëpi nga plaka që mereshin me këto punë, por që rasteve të vështira nuk ishin në gjendje që t'u bënin ballë. E mbajti me gji një nga hallat e tij që kishte të vogël në gji.

Pa u rritur mirë, e ndoqi edhe një fatkeqësi tjetër, i vrasin të atin. Ai u gjet i goditur me sëpatë pranë një ahu që kishte prerë në pyll. Edhe pse shkaku i kësaj vrasjeje nuk u zbulua, vrasësi u bë i njohur. Ishte plumbi i gjakmarrjes që e ndoqi edhe atë nga pas.

Për të mos e mbyllur derën e tij, djalin e vogël e larguan nga fshati. I mbetur larg të tijve e kaloi gjithë jetën deri sa u burrërua dhe filloi të eci me këmbët e veta.

Shërbimin ushtarak e kaloi në një repart artilerie. Në këtë repart mbeti edhe pas përfundimit të ushtrisë si specialist për mirëmbajtjen e mortajave.

Në këtë kohë e njohën me një fqinjën time, me të cilën edhe u martua. Kjo është koha kur u njoha me të. Por kjo martesë nuk i pati ditët të qeta. Dikush kishte lajmëruar komandën e repartit për disa cene që kishte e shoqja në biografi. I kërkuan ta linte. Por ai nuk pranoi.

E pushuan nga puna. Pas një kohe u hap një dyqan në ndërmarrjen e artizanatit për mirëmbajtjen e armëve të gjahut. Atje e punësuan. Ndërkohë u bë edhe me djalë. U duk sikur jeta i hyri në rrjedhë. Por edhe kjo rrjedhë një ditë do t'i ndërpritej.

Një ditë, çuditërisht, erdhi i gëzuar në shtëpi. E kishin thirrur në repartin ushtarak ku kishte punuar, për të marrë pjesë në një lojë të madhe që do të zhvillohej në zonën e Belshit. Gëzimi i tij nuk tregojë. Mendoi se po trokiste e mira sërish në derën e tij. Ai e kishte pasion detyrën në ushtri. Për të edhe ishte specializuar.

Ditën që u nis, u përcoll me gruan dhe me djalin. Djali nga kreu i shkallëve i tha të atit:

- Babi, po të pres, ja këtu! Mos harro të vish!

E pa me lot në sy të birin dhe nuk qe në gjendje t'i kthente një fjalë.

Ishte lamtumira e fundit e Detes.

I biri e kërkonte orë e pa orë dhe e detyronte të emën ta nxirrte në krye të shkallëve.

Disa ditë më vonë, në orët e vona të mbrëmjes, disa drejtues të pushtetit vendor më thërresin dhe më ngarkojnë që të lajmëroja familjen e Detes për një aksident që kishte ndodhur gjatë stërvitjes, por që duhej ta mbaja disi të fshehtë të vërtetën.

M'u rrëqeth mishtë. S'kisha ç'të bëja. Më duhej ta përballoja këtë detyrë.

Sa dëgjoi të trokiturat në derë, djali u ngrit dhe thirri:

- Erdhi babi!

Hija e vdekjes rëndoi mbi atë familje të re.

Pas një ore erdhën përsëri po ata njerëz dhe këkuan të hyjnë në familjen e tij për t'i njoftuar gjëmën.

Në ato çaste më erdhën ndër mend disa pyetje që edhe mund t'u jepje përgjigje:

Ç'ishte ai gëzim i tij para asaj loje me vdekjen? Vallë nuk e mendoi ç'e priste? Po ajo fjalë e të birit? Po lotët e tij a nuk e parathanë gjëmën?

Por ishte e kot të mendoje për këto gjëra. Ajo që ishte bërë, nuk mund të zhbëhej. Pas përfundimit të lojës nga ata që e kishin përjetuar ngjarjen, u mësua e vërteta.

Ishte një pakujdesi. Njëra nga predhat nuk kishte plasur dhe kishte bllokuar mortajën. Në këtë kohë Detja ishte thirrur për të bërë zhbllokimin. Por mbushësi nuk kishte pritur, i kishte futur predhën tjetër. Dhe ndodhi gjëma. Mortaja shpërtheu. Askush nuk pati zemër të afrohej për të mbledhur mbeturinat e trupave që tashmë nuk njiheshin. Pasi kaloi çasti i parë i hutimit, dy prej

atyre që i ruajti fati, i mblodhën pjesët e gjetura në disa batanije.

Kështu ishte thënë. Ai ishte rritur jetim pa nënë dhe pa baba. I biri do të rritej jetim pa baba, por me nënë. Dhe këtu do të ndahej kufiri i kësaj ndërprerjeje për t'i lënë rrugë të hapur vazhdimësisë së jetës.


E shoqja nuk u martua. E lidhi jetën me të birin. Djali si u rrit, u martua dhe sot, me familjen, e ka ngritur jetën në emigracion.

**N**ë ato vite vitet ishin më se të zakonshme mbledhjet e prindërve nëpër fshatra ku kishte rrezen shkolla e mesme. Kështu ndodhi edhe një ditë janari e vitit 1987 në fshatin Levan të krahinës së Shpiragut. Rreth 30 fëmijët e këtij fshati ishin në klasat e ndryshme të shkollës së mesme në Sinjë e çdo ditë pa bërë asnjë mungesë vinin me shumë zell në shkollë. Mes tyre kishte edhe vajza që prisnin njëra-tjetrën e ashtu dy e nga dy viheshin në radhë për të ardhur në orën e duhur në shkollë. Për ironi, shpesh ata vinin në shkollë shumë më shpejt se vetë nxënësit e Sinjës që e kishin shkollën, si i thonë, te dera e shtëpisë. Natyrisht mbledhjet e prindërve bëheshin pasdite vonë, kur prindërit e tyre, kooperativistë vinin nga puna, nga arat, nga stanet e bagëtive. Në pamundësi për të patur një mjedis publik e komod për ta bërë këtë ballafaqim mësues-prindër zakonisht gjendej një oborr para dyqanit të fshatit.

Mbledhja e asaj mbrëmjeje janari pati pjesëmarrje të madhe. Në mbledhje ishin edhe disa kolegë të shkollës 8-vjeçare që në atë kohë flinin në një nga bazat e fshatit. Vërtet ishin të varfër fshatarët e Levanit, po sakrifica që bënin prindërit e jo më pak edhe fëmijët e tyre, ishte vërtet prekëse.


Atë natë shkuam për të fjetur te shtëpia e Lutfiut. Ishte afër qendrës së fshatit, nëse do ta quanim të tillë. Kishte një vajzë në vitin e tretë të shkollës së mesme. Një vajzë që vijonte shumë mirë e mendohej të merrte nota të mira. Na kishte thënë disa herë për ta vizituar shtëpinë e tij. Kishte 6 fëmijë grushta-grushta. Ose më mirë që kishin një moshë një ose dy vjet diferencë nga njëri-tjetri.

Ishte ngushtë me dhoma. Tepër ngushtë. Tre fëmijë i kishte dërguar te fqinjët ose kushërinjtë si i thonin ata. Një burrë trupshkurtër e mjaft i dashur. Zjarri ishte ndezur para se të shkonim ne. I shim dy mësues. Atë natë zonja e shtëpisë natyrisht e kishte pasuruar pak menynë e darkës së familjes. Kishte therur një zog të vogël. Kishte bërë një byrek të hollë e në fund na vuri një pjatë me reshedi, niseshte e pjekur me sheqer. Ndoshta lista e gjellëve të asaj darke miqësore mund të mos bëhej në këtë rrëfim, por ajo ka lidhje pikërisht me ngjarjen që vinte më pas. Në njërin nga dy



## Dhimbja

Namik Selmani



dhomat ku po qëndronim ne, ishin edhe dy djemtë e tij të vegjël, njëri 7 vjeç e tjetri rreth 12 vjeç. Nuk u ulën në tavolinë. Epo, problem zakoni, thamë ne me mend. Rrinin diku në një minder e na shikonin me vemendje. Na dëgjonin e vetëm fantazia e tyre mund të tregonte se ku shkonin duke na dëgjuar. Pas një ore, më i vogli si duket i mundur nga gjumi doli nga dhoma e shkoi të flerë. Tjetri qëndroi me ne deri në fund. Pas nja dy-tri orësh edhe bisedës i erdhi fundi. Të dy palët ishin të lodhura. Ai kishte ardhur nga një pastrim kanalesh kullimi e pas një rrugë të gjatë pas mësimit. Na çuan të flinin në dhomën ku po flinte djali i vogël e diku në minderin e tij do të shtrihet edhe djali tjetër.

Më i madhi prej djemve erdhi pak më vonë se ne e mendonte se ne kishim fjetur. Djali i vogël pasi e kishte pjekur disi gjumin, i thotë vëllait:

- Beni, a mbeti më pilaf në tenxhere?

- Jo, - i tha vëllai më i madh...- Nona e futi të gjithë në pjata.

- Po ndonjë copë byrek a mbeti pa u ndarë?

- Po, mbeti pak e do të na e ndajë nesër në mëngjes.

- Unë dua edhe pak reshedi. A ka lënë nëna ndonjë lugë në tigan?.....

Ishte e qartë. Fëmijët kishin rënë pa ngrënë e kishin fjetur me shpresën se diçka mund të tepronte nga sofrat e miqve. Tek po meditoni të dy në heshtje, i vogli e pyet me zë më të lartë:

- O Beni, edhe sa do që të gdhijë?

Dhimbja kishte arritur kulmin. Të dy ne shokët e një shkolle sytë na mbetën pas atyre dritareve të ngushta sa një frëngji e kullave të malësisë. Duhet të gdhinte shpejt, sa më shpejt që të dy djemtë e Lutfiut të vraponin te prehëri i nënës e të hanin një lugë të mbetur nga pilafi, disa petë byreku dhe të ndanin paqësisht dy lugët e reshedisë në tiganin e vogël. Edhe pika e lotit në sytë tanë nuk do të ishte kurrsesi turp për atë natë migjeniane. Fjetën me ëndrën e një mengjesi ku pas varfërisë do t'i priste një tingull zileje, një faqe libri e hapur.

Mikut ia treguam shumë vonë, pas disa muajsh se çfarë na ndodhi në atë natë janari. U skuq. Padyshim ndjeu edhe dhimbje. Dhimbje për fëmijët e pangopur. Dhimbje për pamundësinë që nuk bëri shumë më tepër për miqtë e

# Faqja sport

## Alpinisti i vetëm në Berat

Mjeshtri i alpinizmit Koçi Maqina është në Berat alpinist i vetëm që po vazhdon karrierën e këtij sporti të harruar. Ky vit shënon të 32-tin vit të ushtrimit nga ky alpinist tashmë edhe instruktor i ekipit të alpinistëve të vegjël në QKF të qytetit tonë.

Koçin e afroi në ekip Mjeshtri i Merituar Petraq Kule. Fillimisht ishin shokë gjuetie. Mjeshtri pa te Koçi dashurinë për natyrën, relievin plot kontraste, pasionin për qytetin, dëshirën për t'u bërë alpinist, aftësitë fizike dhe guximin.

Kaluan vite, Koçi përfitoi shumë nga mjeshttrat e alpinizmit të ekipit "Tomori" dhe të vendit, gjatë organizimit të veprimtarive alpinistike kombëtare.

Në bisedë me Koçin njihje me shumë veprimtari lokale dhe kombëtare dimërore dhe verore, sidomos në Alpe, Korab, Dajt, Nemërçkë, Tomor, etj.

Gjatë këtyre veprimtarive Koçi ka treguar aftësi në përvetësimin e elementëve bashkëkohorë të këtij sporti duke u bërë ndër alpinistët më të mirë të brezit të dytë në shkallë vendi.

*Përgatiti faqen sportive  
Vlash Pambuku*

## FUTBOLL

### Edhe ne po sakrifikojmë për futbollin

Bisedoja një ditë me futbollistët të vegjël të ekipeve sportive. Ata më folën me hollësi se kishin dëgjuar nga sportdashësit e moshuar se brezat e mëparshëm, sidomos futbollistët para vitit 1960, kanë sakrifikuar shumë. Dhe këto ata i besonin, por edhe ju, më thoni, duhet ta dini se edhe ne jemi duke sakrifikuar për futbollin.

Ja se çfarë më folën më tej ata: "Në të vërtetë ne kemi uniforma të bukura që ke qejf të luash, kemi topa të mrekullueshëm, madje secili stërvitet me një top, kryejmë stërvitjen nën drejtimin e specialistëve etj, por përsëri këto kushte nuk mjaftojnë që ne të bëhemi futbollistë cilësorë. Ne luajmë në fusha që në ditë me lagështirë kthehen në moçale, ndërsa në ditët me diell stërvitemi me dyndje lojtarësh. Jo vetëm kaq, -vazhdojnë të tregojmë fëmijët, - futbollistët e viteve të mëparshëm për ndeshjet që luanin jashtë nuk e vinin dorën në xhep, ndërsa me ne nuk ndodh kështu. Ka raste që edhe paguajmë për udhëtime të largëta, ku dihet se disa nga

prindërit janë në asistencë apo të papunësuar.

Dhe unë si futbollist veteran i atyre viteve dhe si njohës i jetës të sportistëve të vegjël të qytetit tim, them se është një e vërtetë se këta po sakrifikojnë për futbollin tonë.

Sigurisht, se këto rreshta nuk i shkrova vetëm për të njohur sportdashësit se si futbollistët e vegjël po sakrifikojnë, por edhe si një mesazh që u drejtohet bashkisë së Beratit, futboll-klub "Tomorit", Federatës Shqiptare të Futbollit, me qëllim që gjendja të ndryshohet, pasi kështu si brezi i ri po stërvitet, nuk premtion që ne të sigurojmë për të ardhmen futbollistë cilësorë

Në kombinatin e tekstileve në Berat ka dhënë kontribut në gjallërimin e jetës fizikore-sportive. Ka drejtuar disa grupe me të rinj dhe të reja. Ishte nismëtar i grupit të alpinistëve tekstilistë për organizimin e ekspozitave turistike-alpiniste si në Llogara, Gramoz, Pogradec, Libohovë, Dajt, Tomor e gjetkë.

Në vitin 1977 në qendrën kulturore të fëmijëve në Berat do të ngrihej grupi i alpinistëve të vegjël. Këshilli i trajnerëve të alpinizmit "Tomori" vendosi që këtë ekip ta drejtojë Mjeshtri Koçi Maqina.

Sigurisht se për Koçin kjo detyrë e re ishte edhe mbingarkesë, pasi ai ishte edhe pjesëtar i ekipit "Tomori" dhe i duhej të stërvitej dhe nga ana tjetër me alpinistët e vegjël, duhej të justifikojë punën dhe t'i bëjë ata alpinistë të ardhshëm për ekipet e "Tomorit" më lart.

Gjatë periudhës 1980-1989, ekipi i alpinistëve të QKF, ishte padyshim më i miri në shkallë vendi. Disa herë në Berat u organizuan seminare kombëtare ku jepej përvoja nga ekipet.

Pjesëmarrja në ekipe e vajzave dhe aftësia e tyre e futur në këtë sport, sigurisht ishte meritë e këtij instruktori. Elementët e futura u demonstruan në festat sportive "Dita olimpikë", si ngjitje e zbritje me litar nga lartësitë, kalime teleferiku, ngjitje në faqet shkëmbore, ngritja e kampingut, etj.

Në bisedë me Koçon ai të flet për kënaqësinë që ka në përgatitjen e porosinë e fëmijëve që stërvitet, por të flet edhe për pakënaqësinë që ka nga mungesa e ekipeve të tjera me qëllim që alpinistët e vegjël të mos e ndërpresin karrierën për t'u bërë alpinistë.

Ekpedita alpinistike, Koçi pranë kameramanit

## Sandri

Sportdashësit e moshuar të qytetit tonë kanë patur rastin ta njohin Aleksandër Prekën (Sandrin), futbollist i "Tomorit", aktivizuar në kampionatet kombëtare 1954-1955.

Sandrin e kisha shokë, pasi ishte mbajtur enkas si futbollist për ta bërë shërbimin ushtarak në Berat. Ishte djalë i pashëm, fisnik, vishej me gusto që për këtë ne i thërrisnim kont.


Sandri u aktivizua me ekipin "Tomori" në ato kampionate, ku ekipi shquhej për kondicionin e lartë fizik dhe për rezultatet.

Luante me lushnjarët: Raq Pisku, Hajdar Sherifi (Dakja), Naun Kondakçiu, fierakun Jani Panajoti, beratasit Polizoi Konomi, Asqeri Zinxhiria, Vangjel Vera, trajner Stavri Janinoti.


Sandri luante mesfushor. I qetë, racional, i saktë, me përgatitje të lartë fizike e taktike.

Pas shërbimit ushtarak iu bë ofertë nga klubi sportiv "Tomori", për të qëndruar në Berat, por nuk qëndroi për arsye familjare.

Gjatë qëndrimit në Berat, Sandri u njoh me Liljanën, vajzën beratase nga lagja "Vakëf". Pas stërvitjeve u ngjitej rrugicave të "Vakëfit" për të kaluar në repartin ushtarak. Dashuria e sinqertë e të rinjve u bë e përjetshme.



1955, "Tomori" (Sandri i dyti ulur)




1982, (Sandri i dyti)

Mbasi largohet nga karriera futbollistike, luan rolin e gjyqtarit të futbollit. Në Federatën Shqiptare të Futbollit, ka qenë i ngarkuar me detyra në kolegjiunin e gjyqtarëve duke dhënë kontribut me vlerë. Shpesh Sandri gjykonte në Berat "Tomorin". Kur vinte në Berat, tifozëria ishte më e qetë, kishte edhe nga ata që flisnin me humor, sot do të fitojmë se e kemi dhëndër Beratit.

# Fotografi nga Roshniku

U bë shkak për këtë shkrim një foto që më ra në dorë dhe më tërhoqi vëmendjen. Si njohës i fotografisë artistike, vlerësova punën. Ndërkohë më shtyti edhe kureshtja se cili ishte fotografi i kësaj fotoje.



Ishte një foto kolor, e fiksuar në aparat dhe e stampuar e qartë dhe me nivel.

Mësova se autor ishte fotografi, kameramani nga Roshniku, Myqerem Katollaku.

Takohem me Myqeremin. Në albumet kishte koleksionuar dhjetëra foto artistike. Prej tyre zgjodha për gazetë vetëm dy.

Në bisedë me Myqeremin mësova disa gjëra nga jeta e tij, kryesisht në drejtim të jetës së fotografisë.

I vogël Lelemi, siç e thërrisnin shokët në fshat, kishte prirje për të vizatuar, për vjersha, prozë dhe dallohej në grupet artistike të shkollës. Në moshën e



rinisë është një veprimtar i shkathët për gjallërimin e jetës kulturore-artistike- sportive në fshat.

Shtatë vjet kaloi në emigracion në Greqi. Realizon dëshirën e fotografit që e ëndërronte që në vogëli, duke blerë aparatura moderne.


Kthehet në Roshnik dhe nis aktivitetin fillimisht me familjen, pastaj me të afërm, miqtë, shokët e pastaj në gjithë fshatin e lindjes. Jehona u përhap në Berat, Fier, Lushnje, Poliçan jo vetëm si veprimtari, por edhe si nivel i fotove.

Karakteristikë e Myqeremit në punimet e tij ishte thyerja e monotonisë, kopjimit të punës, të cilat ethyen nga puna krijuese.

Sigurisht, se në të ardhme, lexuesi do të ketë rastin të shikojë në faqet e gazetës foto artistike nga fotografi i Roshnikut.



## Karrige për Bar- Restorante




tel: 036220295

## PREKNI TE ARDHMEN Drejtor Ilir Qepa

ADRESA:

AGJENSIA E AUTOBUZAVE  
PERBALLE XHAMISE SE PLUMBIT.



tel: 0692063390 - 0692063392

## FIRMA "DAED"

Ndërton në Berat, Durrës, Sarandë

**BERAT:** Pallat me 8 kate, apartament me sipërfaqe 160m<sup>2</sup> pranë xhamisë në Çelepias, okazion, çmime tepër të arsyeshme.

**DURRËS:** Pallat me 5 kate ( shtëpi pushimi komode 1+1), te Shkëmbi i Kavajës, vija e parë buzë detit.

**SARANDË:** Pallat me 5 kate( 1+1) pranë Disko "Mango"-s  
Komoditet, cilësi, çmime të arsyeshme